

KOÇO BIHIKU

RRETH ZHVILLIMIT TË LETËRSISË SHQIPE TË LUFTËS NACIONAL ÇLIRIMTARE

Qëndrimi antikombëtar i klasave drejtuese dhe i klikës së Zogut, që më 7 prill 1939 e lanë popullin në thonjt e agresorit fashist, shkëlja e vendit prej forcave zaptajnëse italiane, që menjëherë filluan të zbatojnë politikën e shtypjes së egër dhe të çkombëtarizimit, pesë vjet ndjekjesh, arrestimesh vrasjesh dhe internimesh që hoqi populli shqiptar nën robërinë e fashistëve, italianë e gjermanë, përfatuan lëvizjen e fuqishme Nacional Çlirimtare. Kjo lëvizje, e cila u udhëhoq prej komunistëve, qe përpjekja më heroike dhe më e përgjakëshme, që populli shqiptar ka bërë gjatë ekzistencës së vet. Në sajë të kësaj luftime ai fitoi lirinë e vërtetë dhe pavarësinë e plotë kombëtare. Duke ngadhnjyer në këtë luftë, populli shqiptar jo vetëm dëboi pushtuesit e huaj prej vatrës dhe krijoi shtetin e vet sovran, por njëherazi e shpëtoi përgjithnjë vendin prej kthetrave të shteteve grabitqare imperialiste.

Lufta Nacional Çlirimtare ka rëndësi të madhe historike, sepse me të triumfoi edhe revolucioni popullor, që shembi për tokë rendin e vjetër politik dhe sheshoi udhën për ecjen e Shqipërisë në socializëm.

"Lufta Nacional Çlirimtare, — ka thënë shoku E. Hoxha, — është faqja më e ndritur e historisë së popullit shqiptar, pse ajo çliroi njëkohësisht Atdheun nga zgjedha e okupatorëve fashistë, dërmoi përgjithmonë klasat sunduese feodalo-borgjeze, i dha pushtetin e plotë popullit." 1).

Gjatë lëvizjes së popullit shqiptar kundër zaptuesve fashistë dhe veglave të tyre, u rrit një letërsi me cilësi të reja ideore e artistike. Ajo lindi si pasqyrim i luftës heroike kundër skllavëruesve të huaj. Në këngët, poemat, publicistikën dhe skicat e kësaj kohe gjeti shprehje entuziazmi revolucionar patriotik, që kishte përfshirë të gjitha forcat e shendosha të kombit, heroizmi dhe sakrificat e masave popullore në përleshje me sunduesit fashistë. E përfutur nga lëvizja masive antifashiste për çlirimin e vendit, letërsia e re, nga ana e saj, ndihmoi për forcimin e qëndrësës së popullit kundra armiqve, duke nxitur ndjenjën patriotike, duke kallur në shpirtin e masave besimin në forcat e veta dhe në fitoren e çështjes së çlirimit të vendit e duke ia hequr bojën manevrave demagogjike të fashizmit dhe të veglave të tija.

Letërsia e luftës Nacional Çlirimtare pararendi letërsinë e sotme shqipe; ajo është paraardhësja e drejtpërdrejtë e saj. Mjaft tipare të letërsisë së realizmit socialist, si fryma e partishmërisë, karakteri i vetëdijshëm popullor e revolucionar, perspektiva e qartë e së ardhëmes nxorën kryet qysh në vitet e luftës. Prandaj njohja dhe studimi i prodhimit letrar të asaj kohe është i nevojshëm për të kuptuar si u rrit dhe u formua letërsia e tanishme. Por në letërsinë e lëvizjes Nacional Çlirimtare gjejmë realizime, të cilat jo

1) E. Hoxha — Fjalim i mbajtur në mbledhjen solemne me rastin e dhjetvjetorit të çlirimit, Tiranë, 1954, f. 9.

vetëm kanë vlerë historiko-letrare, por ruajnë një forcë jo të rëndomtë shprehëse ideore e artistike e kënaqin edhe sot nga ana estetike lexuesit.

*
*
*

Populli shqiptar nuk i u nënështrua zgjedhës së huaj. Qëndresa që i u bë më 7 prill 1939 agresorëve fashistë, gjatë viteve 1939-1940, erdhi duke u rritur dhe forcuar. Në fillim ajo shpërtheu në formën e mosbindjes ndaj ligjeve të pushtuesit, të bojkotimit të hapur të masave që mirrnin autoritetet fashiste për të fashistizuar dhe çkombëtarizuar vendin, të grevave në fabrikat e pronarëve shqiptarë dhe në ndërmarrjet që punonin për armikun, të sabotimit të planeve të pushtuesve dhe të agjentëve të tyre për t'i detyruar shqiptarët të derdhnin gjakun në vendet e huaja për interesat e fashizmit. Këto akte i shkaktonin dëme të ndjeshme armikut dhe fushin demoralizim në radhët e tija. Autoritetet pushtuese shpallën dekrete, që parashikonin dënime të rrepta deri në pushkatim. Por megjithë arrestimet, burgosjet dhe internimet vala e lëvizjes popullore antifashiste vijonte të ngrihej pandërprerë.

Hyrja në luftë e Bashkimit Sovjetik kundra Gjermanisë naziste luajti një rol vendimtar në zhvillimin e lëvizjes Nacional Çlirimtare në Shqipëri. Pas kësaj fati i popujvet, që lëngonin nën thundrën e egër fashiste, u lidh ngushtë me luftën çlirimtare të popujve sovjetikë, me sukseset e Ushtrisë së Kuqe. Bashkimi Sovjetik u bë mbështetja kryesore e popujve të shtypur të Evropës, në luftë kundra pushtuesve fashistë, garancia e sigurtë për çlirimin e tyre të vërtetë.

Shpirti i qëndresës popullore ishin komunistët. Në çastet kritike që kalonte Shqipëria, ata, i treguan popullit shqiptar rrugën e vërtetë të fitimit të lirisë dhe të pavarësisë kombëtare, u hodhën të parët në luftë duke ngjallur tek njerëzit besimin dhe frymën patriotike. Në këtë kohë në historinë e popullit shqiptar ndodhi një eveniment me rëndësi të madhe: më 8 nëndor 1941 u themelua Partia Komuniste Shqiptare. Bashkë me hyrjen e Bashkimit Sovjetik në luftë kundra agresorëve hitlerianë, formimi i Partisë Komuniste, shenoi nisjen e një etape të re në zhvillimin e luftës Nacional Çlirimtare. Nën drejtimin e komunistëve ajo u zhvillua me hov të madh, duke marrë karakter më të organizuar dhe përpjestime më të gjera. Nga fundi i vitit 1941 në qytete dhe në fshatra u ngritën njësitë e para guerile, kurse gjatë vitit 1942 mori zhvillim lufta partizane. Në pranverë të këtij viti përveç çetës së Pezës, që vepronte qysh prej gushtit të vitit 1941, çeta partizane u krijuan edhe në krahina të tjera, si në Kurvelesh, Gorë, Skrapar, Mokër dhe Devoll. Ato erdhën duke u shtuar dhe në fund të vitit numri i tyre arriti në 25. Çetat goditnin autokollonat armike, shkatërronin depot dhe kazernat ushtarake, sulmonin përqëndrimet e trupave fashiste, shkatërronin postat e karabinjerisë dhe të milicisë, çlironin krahina të tëra dhe vendosnin aty pushtetin revolucionar të masave popullore.

Të tronditur nga lëvizja masive, që po rritej nga dita në ditë, pushtuesit fashistë u shtrënguan të manovrojnë. Në vend të çifligarit të madh Shefqet Verlacit, vunë kryeministër të qeverisë kukull agentin e tyre të vjetër Mustafa Krujën. Për të shkatërruar organizimin dhe bashkimin e arritur në luftë të popullit shqiptar, M. Kruja, nga njera anë përdori demagogjinë dhe premtimet dinake, kurse m'anë tjetër e bëri edhe më të ashpër terrorin kundra lëvizjes çlirimtare. Milicët dhe karabinjeria fashiste ndoqën me egërsi e brutalitet popullin dhe të rinjtë. Qindra veta u vranë ose u masakruan në mënyrë barbare, qindra të tjerë u hodhën në burgje ose u internuan në kampe përqëndrimi dhe në ishujt e Italisë. Kundra bazave të luftës, Pezës dhe kra-

hinës së Vlorës, u dërguan forca të shumta të armikut, të cilat dogjën shtëpitë e fshatarëve, vranë në masë gra, fëmijë e pleq, rrëmbyen gjënë e gjallë. Operacione ndëshkimore armiku organizoi edhe në zona të tjera, por ai nuk ia arriti të shuajë qëndresën e popullit. Forcat partizane, të mbështetura nga fshatarësia patriotike i përballuan me sukses mësymjet e armikut dhe në shumë krahina u hodhën në sulm. Nga fundi i vitit 1942 ato çliruan krejt Pezën, Skraparin, Tomoricën, Kurveleshin, Martaneshin, etj.

Shprehje e sukseseve të mëdha që arriti lëvizja çlirimtare në këtë kohë ishte Konferenca e Pezës, që u thirr në shtator të vitit 1942 me iniciativën e Partisë Komuniste Shqiptare. Në konferencë u hodhën themelet e Frontit Nacional Çlirimtar të popullit shqiptar dhe u zgjodh Këshilli i Përgjithshëm Nacional Çlirimtar. Mbledhja mori një varg vendimesh shumë të rëndësishme, të cilët i dhanë dorë forcimit dhe rritjes së mëtejshme të luftës kundra agresorëve të huaj dhe shërbëtorëve të tyre.

Përballë sukseseve të rëndësishme të lëvizjes Nacional Çlirimtare reaksioni i brendshëm, i ndihmuar prej pushtuesit fashist, shpejtoi të grumbullojë një pjesë të forcave të veta. Kështu në fund të vitit 1942 lindi Balli Kombëtar, në të cilin hynë politikanë aventurierë, intelektualë borgjezë, kulakë, tregtarë të mëdhenj, oficerë dhe klerikë reaksionarë. Balli u ngrit për të penguar fitoren e popullit dhe të Partisë Komuniste. Në sytë e popullit ballistët u shtjënë si nacionalistë, që luftonin për "lirinë e Shqipërisë", por në të vërtetën ata s'lanë gurë pa lojtur për të prishur bashkimin e popullit. Zhvillimi i ngjarjeve dhe, në radhë të parë, forcimi i luftës Nacional Çlirimtare nxori në shesh rolin e ballistëve si vegla të pushtuesit fashist. Në pranverë të vitit 1943 Balli Kombëtar nënshkroi një protokoll me italianët, në bazë të cilit mori përsipër të shtypte lëvizjen Nacional Çlirimtare. Pas kësaj çetat balliste, të përbëra prej kriminelësh dhe hajdutësh filluan të goditnin prapa krahëve partizanët, të vrisnin komunistë dhe aktivistë të luftës, të ndihmonin drejtpërdrejt forcat armike në operacionet ndëshkimore kundra bazave të luftës.

Fitoret vendimtare të ushtrisë sovjetike, sidomos epopeja e lavdishme e Stalingradit dhe afrimi i shembjes së maqinës ushtarake fashiste, si kudo ngjallën entuziazëm dhe besim të madh edhe në popullin shqiptar. Nën ndikimin e këtyre ngjarjeve gjatë vitit 1943 lëvizja Nacional Çlirimtare mori përpjestime të gjera dhe nisi të kthehet në një kryengritje të përgjithëshme popullore. Në luftë të pandërprerë me armiqt u rrit numuri i forcave partizane; radhët e tyre u mbushën me puntorë, fshatarë dhe nxënës. Në muajin maj u krijuan batalionet e para partizane, kurse në fillim të korrikut numri i tyre arriti në 20, përveç çetave të shumta partizane. Gjatë vitit 1943 re-partet partizane kaluan në veprime të kombinuara edhe i dhanë goditje të ndjeshme armikut. Nga përpjekjet e shumta që forcat popullore kryen me sukses kundër armiqtve, duhet përmendur sulmi i madh që 1250 partizanë të reparteve të Korçës, Gjirokastrës, dhe Skraparit ndërmorën në muajin korrik kundër forcave fashiste në Kuqar dhe Përmet. Në këtë ndeshje armiku u tërhoq prej rrethit të Përmetit, pasi ia në fushën e luftës 500 të vranë. Mësymjet e pareshtura partizane në të gjitha krahinat e Shqipërisë krijuan një gjendje pasigurie dhe të paqëndrueshme për pushtuesit e huaj dhe tradhëtarët. Në verë lufta e armatosur u bë më e ashpër dhe mori karakter edhe më të organizuar. Nga bataljonet e çetat partizane, që vepronin në të katër anët e vendit, u formua Ushtria Nacional Çlirimtare, e cila në çastin e themelimit numuronte në radhët e saj 10 mijë veta, përveç 20 mijë luftëtarëve të çetave vullnetare të fshatrave dhe të njërive guerile në qytete. Në krijimin e forma-

cioneve të mëdha ushtarake kryengritja e armatosur e popullit shqiptar kundra pushtuesve të huaj hyri në një fazë të re. Në muajt korrik e gusht në rrethin e Pogradecit, Burrelit, Korgës dhe të Shkodrës u zhvilluan luftime të ashpra, gjatë të cilave armikun iu shkaktuan dëme të mëdha në njerëz dhe në plaçka. Sulmet kundra ushtrisë fashiste u bënë të shpeshta në prak dhe pas kapitullimit të Italisë.

Me ardhjen e trupave hitleriane gjendja u ndërlikua. Lëvizjes Nacional Çlirimtare iu krijuan vështirësi të reja. Sapo shkelën në Shqipëri nazistët përpunuan një plan të gjerë kundër popullit shqiptar. Komanda gjermane mbledhi dhe organizoi të gjitha forcat e reaksionit të brendshëm me në krye ballistët e Legalitetin dhe shpërtheu një terror të egër kundra popullsisë. Por lufta e armatosur nuk u ndërpre, përkundrazi ajo u zhvillua më e ashpër dhe në shkallë më të gjerë se përpara. Në Drashovicë, Konispol, në afërsitë e Borshit, në qarkun e Beratit, në manastirin e Cepos, në Tragjaz, Gjormë e Lepenicë, në rrugën Elbasan - Tiranë dhe Librazhd-Elbasan e gjetiu ushtria Nacional Çlirimtare zhvilloi beteja të rrepta me trupat pushtuese dhe bashkëpunorët e tyre, të cilët disa herë arrinin në mijra vetë. Në përpjekje të përgjakëshme me armiqtë, në vjeshtë të vitit 1943, repartet e rregullta partizane hynë ngadhjyese në Berat, Krujë, Bilisht, Gjirokastër, Peshkopi, Tepelenë, Sarandë, etj., duke vendosur përkohësisht në to pushtetin e këshillave Nacional Çlirimtare.

Rritjen e valës së luftës nuk mundën ta shtypin as operacionet e mëdha, që ushtritë naziste, të mbështetura nga mijra xhandarë, ballistë dhe zogistë, ndërmorën në dimër 1943-44 dhe në qershor të vitit 1944 për të zhdukur Ushtrinë Nacional - Çlirimtare, as terrori i zi që reaksionarët shpërthyen në qytetë, as vrasjet, plaçkitjet dhe djegjet, që bënë forcat hitleriane bashkë me tradhtarët, as bllokada, që ata ngritën për të shtrënguar të dorëzohen nga uria krahinat malore, ku kishin bazat e tyre forcat partizane. Nga betejat e përgjakëshme me fashistët gjermanë Ushtria Nacional Çlirimtare doli edhe më e fortë; në vend që të pakësoheshin, radhët e saja u shumuan. Pasi shkatërroi planet e komandës gjermane ajo u hodh në sulm për çlirimin e të gjithë Shqipërisë. Duke goditur ushtritë naziste dhe bandat mercenare të ballistëve dhe zogistëve në verë të vitit 1944 partizanët çliruan me radhë Pogradecin, Gjirokastrën, Beratin, Vlorën, Korçën, etj., dhe më pas Durrësin, Elbasanin dhe Tiranën. Më 29 nëntor 1944 pasi dëboi nga toka amtare mbeturinat e fundit të nazistëve gjermanë dhe të reaksionarëve të ndryshëm. Ushtria Nacional Çlirimtare hyri në qytetin e Shkodrës. Me çlirimin e vendit u realizuan ëndërrat më të shtrënjta të popullit shqiptar. Shqipëria u çlirua plotësisht. Lufta pesëvjeçare kundra pushtuesve të huaj, heroizmi dhe sakrificat e bëra, gjaku i derdhur nuk shkuan kot. Planet e klasave reaksionare të politikanëve dallaverexhinj dhe të agjentëve të huaj për të ruajtur në Shqipëri rendin e vjetër politik dhe shoqëror, u përmbysën. Në të katër anët e vendit u ngrit pushteti i ri, pushteti i masave popullore. Kjo ishte fitorja më e madhe e popullit shqiptar gjatë historisë së tij shekullore.

Duke iu drejtuar kësaj epopeje heroike, nuk mund të mos vemë në dukje meritën e madhe të letërsisë revolucionare ilegale, e cila, duke vijuar traditën e letërsisë së Rilindjes Kombëtare, të letërsisë përparimtare të viteve '30, të Nolit, Migjenit, etj. mori pjesë aktive në luftën popullore dhe dha një kontribut të çmuar për çlirimin politik dhe shoqëror të masave punonjëse.

Qysh në ditët e para të pushtimit, fashistët nisën të vënë në jetë çkombëtarizimin dhe italizimin e jetës shoqërore dhe mendore të vendit. Të gjitha gazetaret dhe revistat, që dilnin para 7 prillit 1939 (përveç "Hyllit të Dritës") u ndaluan dhe, në vend të tyre, ata nxorën organet e veta si "Fashizmi",

"Tomori", etj. Me ligje të shpallura u vendos një censurë e rreptë, që ndiqte çdo mendim të lirë dhe çdo kritikë kundra pushtimit të Shqipërisë dhe kundra rregullave të vendosura nga sunduesit e huaj. Jeta mendore u vu nën kontrollin e rreptë të autoriteteve pushtuese. Letërsia klasike botërore, që predikonte idetë e mëdha të lirisë së popujve, të përparimit shoqëror dhe të demokracisë u shpall si "subversive". Por, duke ndaluar gjithçka që ishte në kundërshtim me ideologjinë fashiste, pushtuesit e mbushën vendin me libra dhe broshura propagandistike, ku Italisë i atribuohet roli i "shpëtimtarës" së popullit shqiptar prej zgjedhës së Zogut dhe pushtimi fashist paraqitej si fillimi i epokës së "prosperitetit" për Shqipërinë. Skllavëruesit italianë ngritën një varg organizatash dhe institucione shqiptare (dopolavoro etj.), të cilat bënin çmos për të helmatisur ndërgjegjen e njerëzve me ide fashiste dhe për të çrrënjësuar vetëdijen kombëtare. Në tekstet shkollore dhe botimet e ndryshme e kaluara historike e Shqipërisë u falsifikua sipas interesave të propagandës fashiste.

Planet e tyre të kolonializimit dhe të italianizimit të Shqipërisë fashistët u përpoqën t'i fshenin pas perdes së "vllazërimit" të popullit shqiptar me atë italian, të "fateve" të përbashkëta, me të cilat ata gjoja i kishte lidhur historia ç'prej kohësh. Për të krijuar përshtypjen, se i duan të mirën Shqipërisë dhe popullit të saj, pushtuesit e huaj ndërmorën edhe disa inisiativa kulturore, si ngritjen e Institutit të studimeve shqiptare, që vendosi hartimin e një fjalori të gjubës dhe studimin e historisë dhe të kulturës shqiptare, por të gjitha këto u bënë me qëllim për të gënjyer shqiptarët. Në të vërtetë gjatë pushtimit u bë çmos që të libeshin në harrësë traditat kulturore patriotike dhe përparimtare të popullit shqiptar.

Për realizimin e synimeve të tyre antishqiptare fashistët italianë vunë në lëvizje agjentët e tyre të vjetër Mustafa Krujën, Ernest Koliqin, Lazër Shantojën, Vangjel Koçen, klerin reaksionar françeskan e jezuit dhe blenë një varg publicistësh dhe letrarësh pa talent.

Vitet e pushtimit fashist qenë një periudhë shumë e rëndë për letërsinë shqipe. Ai zhvillim i mbarë që u vrejti nga fundi i viteve '30 dhe u çfaq në dukjen e një varg talentesh të reja dhe në rritjen e prodhimit artistik u ndërpre. Jetën letrare e pllakosi shkrëtia dhe heshtja. Vepra të reja letrare shqipe pothuajse nuk u botuan fare. Në vëllimin e përgjithshëm të librave të shtypura më të shumtën e përbënin botime propagandistike fashiste, vepra ku ipeshin njohuri gjeografike dhe ekonomike mbi Shqipërinë për italianët, botime ligjesh dhe urdhërësash të autoriteteve zaptuese, botime fetare dhe përkthime romanesh pa vlerë nga italishtja.

Pushtuesit e huaj bashkë me agjentët e tyre, si E. Koliqi, V. Koça, etj. u orvatën me të gjitha mënyrat që të zhvillojnë në Shqipëri një letërsi apologjetike fashiste. Duke u shtirur si përkrahës të artit dhe të letërsisë dhe duke ndarë shpërblyeme në të holla dhe sinqere, ata luftuan që të afrojnë dhe të shfrytëzojnë për qëllimet e tyre njerëzit e kulturës dhe shkrimtarët. Për këtë qëllim nxorën revistën kulturore e letrare "Shkëndia" dhe gazetën letrare e shoqërore "Tomori i vogël". Por ata nuk ia arritën qëllimit. Bashkëpuntorët aktivë të gazetave dhe revistave fashiste u bë një grup letrarësh dhe gazetarësh të rinj, shumica e të cilëve e shikonin punën letrare si mjet për të nxjerrë fitime dhe për të bërë karrierë. Me shkathtësi të veçantë ata iu përshtatën kërkesave të propagandës fashiste dhe nisën të furnizonin shtypin me shkrimet e tyre, ku propagandonin koncepte reaksionare dhe antidemokratike. Nga shkrimtarët e njohur anën e pushtuesit hapur e morën Gj. Fishta dhe E. Koliqi. Ata e aprovuan dhe e brohoritën skllavërimin e Shqipërisë. Në këtë periudhë, keta s'krijuan gjë me vlerë në lëmin e letërsisë, por me

Paqartësia në të konceptuarit historikisht të fakteve dhe ngjarjeve bëri; që në trajtimin e problemit të shkatërrimit të rendit kapitalist dhe të triumfit të revolucionit botëror, poeti të shkëputet nga rrethanat dhe faktet konkrete dhe t'i pasqyrojë ngjarjet revolucionare nepërmjet simbolesh, figurash abstrakte e konvencionale, të cilat fusin shpesh në vepër errësirë. Ngadhënjimi i revolucionit del në disa vende si përmbysje kataklike, si shpërthim forcash spontane, të paorganizuara, që udhëhiqen vetëm prej pasioneve dhe urrejtjes ndaj shfrytëzimit.

Megjithatë poema "Horizonti në kuletë" të rrëmben me pathosin revolucionar, me idenë madhështore të triumfimit të socializmit në shkallë botërore, me figurat e guximëshme dhe origjinale. Brenda e poemës që përbehet nga shkrime të forta emocionale, furi, zemërim dhe shpërthime me gulsha të ngazellimit për çlirimin e afërt, është shprehur me anë të hiperboleve vigane, antitezash, krahasimesh të papritura, metaforash që formojnë katakrezë, simbolesh fantastike. Në pajtim me poetikën e saj të vullëshme dhe tronditëse është edhe kompozicioni i copëzuar e dinamik, vargu që këputet në mënyrë të parregulltë dhe strofa, e ndërtaur në formë jo të zakonshme. Në te ushtroi ndikim poezia revolucionare e novatore e Majakovskit.

Për nga ideja, fryma dhe mjetet e shprehjes artistike, pranë "Horizonti në kuletë" qëndron poema "Parada e t'uriturve". Në të tingëlloi motivi i vuajtjeve të mëdha, që popujt hiqnin në kërbacin e reaksionit ndërkombëtar, të sundimit kapitalist të shteteve të Evropës perëndimore dhe nën sundimin e egër e brutal të fashizmit. Masat e shtypura të gjithë botës duhet të mos deshëpërohen sepse ua ndrin udhën "Dielli i Leninit" sepse dita e çlirimt po afron — është ideja qëndrore e kësaj poeme, e cila u shkrojt me 1940. "Parada e t'uriturve" ka po ato të meta sikurse edhe "Horizonti në kuletë": karakterin abstrakt, paqartësinë për foreat dhe rrugët e shpëtimit nga robëria kapitaliste, paralelizmat e errta historike dhe përfytyrimin mbi revolucionin botëror si llavë e furishme dhe e papërmbajtur, që do të fshijë nga dheu regjimet kapitaliste.

Në këto vite edhe A. Çaqi shkroi vjersha, të cilat kaluan dorë më dorë dhe u lexuan nga një numur i vogël njerëzish ("Po deri kur?", "Valët e detit", "Lirisë", "Të shtypur më këmbë!" dhe "Më këmbë!"). Shqetësimi për fatin e rëndë të vendit, dëshpërimi, përzier me ndjenjën e sigurisë se së shpejti njerëzit do të ngrihen për të drejtat e tyre, janë notat karakteristike të këtyre vjershave. Në poezinë "Po deri kur?" gjeti pasqyrim gjendja shpirtërore e poetit, të cilin e dërmon atmosfera e skllavërisë së huaj:

Po deri kur do të vazhdojë kjo natë,
që nxiu tërë jetën
dhe bëri ndjenjat gurë
dhe mbyti të vërtetën?

Megjithë hidhërimin, që e ka mbërthyer, poeti s'e ka humbur shpresën; se s'do të kalojë shumë, dhe "turma e uritur" do të ngrihet me një vendim të prerë: "ja vdekje që të gjithë, ja liri". Në vjershën "Valët e detit" poeti e krahason vehten me barkën e vogël, që sado ashpër ta rrahin dallgët e egër-suara të detit, nuk jepet:

Këtë tallaz e ka edhe zemra ime,
por nuk ndalet kurrë dhe nuk mundet,
dhe nga reziqet kurrë nuk tundet,
por rrugën merr si trime.

Zgjimi i masave popullore, rritja e qëndresës kundra pushtuesve fashistë, i dhanë një mbështetje më të fortë optimizmit të tij. Kjo u pasqyrua në vjershat e tija "Të shtypur në këmbë" dhe "Më këmbë!", në të cilat kumboi e vendosur dhe e prerë thirrja për t'u bashkuar dhe për t'u ngritur për liri. Poeti i grish masat e shtypura, punëtorët dhe fshatarët, të ngrihen me guxim për t'u çliruar prej robërisë së huaj dhe zgjedhës shoqërore:

Qe bota të rrojë e lirë,
të shtypur, para për çlirim,
me yll në ball dhe me guxim.

Motivi i shqetësimit për atdheun, që ra në skllavërinë fashiste tingëlloi edhe në vjershën "Shqipërisë" të Dh. Shuteriqit, shkruar më 1940. Shkelja e vendit prej të huajve, tradhëtia e klasave drejtuese e hedh poetin në një dëshpërim të madh dhe e bën të vajtojë pa ngushëllim humbjen e Shqipërisë:

Të mjerët ne, që jemi gjallë,
dhe kemi zemër, kemi mall,
s'bahemi shkamb e t'mbrojmë kudo,
krahut që t'bi si mos Zot jo,
qi t'vuni pushkën mu në ballë. 1)

Ky hidhërim, në poezitë "O motër, kush na tha" dhe "Një ditë e re" ia le vendin besimit që nxjerr kryet në shpirtin e poetit me ardhjen e stinës së re. Vjollca e vogël i kujton atij verën, kohën, kur jeta përtërihet dhe marrin hov shpresat e njerëzve.

Te poezitë e kësaj kohe, bie në sy një farë paqartësie për të ardhmen, e cila jepet në figura simbolike ose përmes pamjeve të përgjithëshme, abstrakte.

II

Zhvillimi i hovshëm i letërsisë revolucionare erdhi pasi lindi e mori përhapje shtypi ilegal antifashist. Format e para të shtypit të luftës qenë traktet dhe thirrjet. Gjatë luftës shtypi i partisë nxori një shumicë thirrjesh dhe traktesh me raste dhe për çështje të ndryshme: "Populli shqiptar", "Punëtorë, fshatarë, qytetarë", "Me rastin e 1 majit (1942)", "Shoku Qemal Stafa ra dëshmor", "Për kujtim të herojve të lirisë së popullit", "Të luftojmë armikun fashist që po na vret e po na var djemt e popullit", "Kurveleshi e bëri fora", "Qytetit heroik të Stalingradit", "Poshtë maskën tradhëtarëve! Poshtë kompromisi Nr. 2", "Hordhitë e Hitlerit në Shqipëri", "Balli Kombëtar gënjen", "Shenjat e para të falimentimit të Ballit Kombëtar", "Pak fjalë mbi Komitetin e Shqipërisë", "Demagogjia naziste dhe kërcënimet kuislinge", "Ushtria e Kuqe — shtylla kryesore e luftës kundër fashizmit", etj. Veç këtyre u botua thirrja, drejtuar posaçërisht fshatarëve ("Katundarëve shqiptarë"), intelektualëve ("Intelektualë shqiptarë, hapni sytë!"), ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve shqiptarë, trupave italiane. Nga 1941 e gjer në vitin 1944 u botuan më se 200 thirrje e trakte në disa mijëra kopje.

Kur lëvizja Nacional Çlirimtare po shkonte duke u zgjeruar për ditë e

1) Dh. S. Shuteriqi, "Këngë", Tiranë, 1961, f. 44

më shumë, dolën organet antifashiste ilegale. Në gusht të vitit 1942 nisi të botohet "Zëri i Popullit", organ i Partisë Komuniste Shqiptare.

Krijimi dhe përhapja e shtypit ilegal antifashist është meritë historike e Partisë Komuniste Shqiptare, organizatores dhe udhëheqëses së luftës çlirimtare të popullit shqiptar kundra agresorëve të huaj. "Zërin e Popullit" e themeluan drejtuesit e partisë në rrethanat e një konspiracioni të madh. Atë e drejtonte vetë E. Hoxha, i cili botoi në faqet e saja shumë artikuj dhe shenime, në të cilat rrihte probleme të rëndësishme të situatës politike të kohës dhe të luftës Nacional-Çlirimtare. "Zeri i Popullit" shtypej në shaptilograf në Tiranë. Komiteti Qëndror i Partisë u dërgonte rrethve një numur të kufizuar kopjesh, të cilat, komitetet qarkore pastaj, i shumëzonin në bazat e teknikës së tyre dhe i shpërndanin në masën e pjesëmarrësve dhe të simpantizantëve të luftës. Kështu arrinte të përhapet në 1500-2000 kopje. "Zeri i Popullit" dilte në formë reviste prej 20-30 faqesh. Më të shumtën e herës ajo u botua dy herë në muaj. Në sajë të guximit të punëtorëve disa numra u shtypën nën hundën e armikut dhe me tipografi. Në rubrikën kryesore botoheshin artikuj për problemet më aktuale të luftës kundra fashizmit; vend të rëndësishëm zinin edhe shkrime mbi çështje ekonomike. Në çdo numur rregullisht botoheshin lajme për sabotime dhe aktet e diversionit kundra trupave dhe depove të armikut, për demonstratat dhe manifestimet që organizoheshin në katër anët e vendit, për veprimtarinë luftarake të çetave, etj. etj. Rubrikë tjetër me rëndësi ishte ajo e komenteve mbi ngjarjet politike të brendëshme dhe ndërkombëtare.

Qysh kur doli, "Zeri i Popullit", u bë shpejt organi i dashur i masave, të cilën e kërkonin dhe e lexonin me etje, megjithë rreziqet, që sillte me vehte një punë e tillë. Revista luftonte kundra shtypit fashist dhe në përgjithësi kundra propagandës armike.

Përveç "Zërit të Popullit" Partia 2-3 herë në javë nxirrte Buletinin e "Zërit të Popullit" (2-4 faqe çdo numur), në të cilin krahas n'otimeve nga tufta e çetave partizane, lajmeve nga fronti i lindjes dhe nga lufta e popujve të shtypur të Evropës kundra murtajës fashiste, trajtoheshin çështje politike të ditës, botoheshin komente të ngjarjeve kryesore politike, u jepesh përgjigje shpifjeve të armikut, demaskoheshin manevrat e propagandës tradhëtare.

Organ tjetër me rëndësi i shtypit antifashist ishte edhe "Kushtrimi i lirisë", që nis jetën e vet po në gusht të vitit 1942. Për nxjerrjen e tij një kontribut të rëndësishëm dha Qemal Stafa, sekretar i parë i K. Q. të Rinisë Komuniste Shqiptare. Në redaksinë e parë të "Kushtrimit të lirisë" bënë pjesë N. Spiru, i cili ishte kryeredaktori i saj, N. Hoxha, Sh. Musaraj, A. Çaçi, Gj. Kuçali, etj.

"Kushtrimi i lirisë" botonte një lëndë të pasur mbi një rreth të gjerë temash; ajo kishte karakterin e një reviste politike, shoqërore, kulturele dhe letrare dhe i drejtohesh shtresave të gjera të rinisë shqiptare. Në faqet e saja gjejmë artikuj, në të cilat flitej për mjerimet dhe të zitë, që fashizmi i solli popullit shqiptar, ajo botonte artikuj, ku nëpërmjet të fakteve historike zbuloheshin qëllimet e vërteta agresive që imperializmi italian kishte ushqyer kundrejt Shqipërisë qysh në fillin të këtij shekulli, shtroheshin detyrat, që i dilnin përpara rinisë shqiptare në luftë për çlirimin e atdheut, fejtone, ku u hiqesh cipa demagogjisë së propagandës fashiste e stigmatizoheshin intrigat dhe manevrat dinake të armikut, shkrime, ku ngriheshin lart figurat e revolucionarëve të shquar, si ajo e H.Xhelos, A. Vokshit, etj. ose përkujtohesh akti suprem për çlirimin e atdheut i të rinjve në luftën kun-

dra fashizmit italian, reportazhe nga jeta e çetave partizane dhe shkrime, ku dënoheshin ashpër krimet dhe sjellja brutale në burgjet fashiste, ku torturoheshin qindra e qindra patriotë të rinj.

Një vend shumë të madh revista i dha letërsisë artistike. Në çdo numur ajo botonte skica, tregime, vjersha dhe pjesë të ndryshme me brendi nga jeta dhe lufta e rinisë antifashiste shqiptare. "Kushtrimi i lirisë" pati meritën, që në vitet e pushtimit të huaj, kur një numur jo i vogël letrarësh e humbën toruan përballë zhurmës shurdhonyjëse të propagandës armike dhe nuk e shikonin qartë, se ç'detyra i dilnin letërsisë shqipe në kushtet e robërisë së huaj, të shtrojë në faqet e saja problemin e krijimit të një letërsie të re në shërbim të popullit luftonjës. Revista bëri hapa konkrete në drejtim të formimit të kushteve për themelimin e një letërsie revolucionare, duke grumbulluar rreth vehtes e duke ndihmuar të rinjtë, tek të cilët vinte re aftësi letrare. Nën shembullin e "Kushtrimit të lirisë" në Korçë, Shkodër dhe Durrës u botuan revista politike e letrare për rininë.

Në vitet 1942-1943 dolën edhe organe të tjera ilegale. Në maj të vitit 1943 filloi të botohej revista "Bashkimi" e Këshillave Nacional Çlirimtare. Në fillim "Bashkimi" doli në Durrës, ku shtypej në shaptilograf në disa qindra kopje, të cilat shpërndaheshin edhe në rrethe të tjera. Veç kësaj letrat e dyllit dërgoheshin në Tiranë, Vlorë dhe Gjirokastër, ku shumoheshin sërish. Disa herë revista u shtyp edhe në tipografi. "Bashkimi" luftonte për grumbullimin dhe bashkimin e të gjithë patriotëve të ndershëm rreth frontit Nacional Çlirimtar, bënte thirrje për forcimin dhe zgjerimin e luftës kundra skllavëruesve fashistë, propagandonte rëndësinë e këshillave Nacional Çlirimtare, informonte mbi veprimtarinë e tyre si në qytete dhe në fshatra, ipte udhëzime për ngritjen dhe funksionimin e tyre etj. Po në vitin 1943 nisi jetën e vet organi i Bashkimit të Grave antifashiste "Gruaja shqiptare".

Kudo ku ndjehej nevoja për të ndikuar nëpërmjet të fjalës tek njerëzit, për t'i organizuar ata ose për t'u ngjallur besim në fitoren mbi armiq, delnin organe ilegale. Krahas përhapjes së luftës së armatosur kundra pushtuesve fashistë dhe veglave të tyre, merr zhvillim shtypi partizan. Çetat, batalionit dhe kompanitë botojnë gazeta xhepi me shumë faqe. Pranë komandave të qarkut e të zonave, në qendra pune të krahinave të çliuruara, pranë spitaleve partizane dolën gazeta muri, në të cilat rriheshin problemet e reja që dilnin; në to u pasqyrua realiteti i ri revolucionar në Shqipëri. Organe shtypi nxorën edhe formacione e mëdha, që u ngritën me zgjerimin më të madh të luftës. Kështu doli "Para Partizan!" i Brigadës I S, "Buçitja" e Brigadës V S, "Ylli partizan" i Divizionit I S, "Përpara" i Divizionit II, "Trumbeta Çlirimtare" e këshillit të frontit N.Çl. të Vlorës dhe mjaft organe të tjera, përveç gazetave të xhepit, që nxirrte pothuaj çdo batalion.

Në faqet e "Zërit të Popullit", "Kushtrimit të lirisë", "Bashkimit", etj. u çfaq dhe mori zhvillim publicistika patriotike revolucionare, e cila lojti një rol shumë të rëndësishëm edukativo-politik gjatë lëvizjes kundra skllavëruesve fashistë. Në vitet e para, kur qëndresa popullore sa po nisi, publicistika ilegale vuri të tëra forcat për të krijuar tek njerëzit besimin në forcat e veta dhe në mundësinë e ngadhënjimit mbi armikun, që ishte një nga kushtet themelore për zhvillimin dhe rritjen e luftës kundra pushtuesit të huaj.

Në lëmin e publicistikës gjatë lëvizjes Nacional Çlirimtare u dalluan udhëheqësit e Partisë: E. Hoxha, N. Spiru dhe shkrimtarët Sh. Musaraj, A. Çaçi etj.

Tema qëndrore e publicistikës së E. Hoxhës ishte ajo e shpirtit patriotik të popullit shqiptar. Shumë artikuj — "28 nëndori dita e bashkimit të popu-

lit shqiptar kundra zaptimit fashist", "Nuk mund të përsëritet koha e vjetër", "Nga Kongresi i Përmetit në çlirimin [e plotë të Shqipërisë", "Vendimet historike të mbledhjes së II të KANÇ-it mbajtur në Berat", — kishin si qëllim të afirmojnë idenë se populli shqiptar nuk do t'i nënshtrohet zgjedhës fashiste. Rrebeshe të tmerrshme i kanë rënë atij mbi kryet, por asnjëherë s'e kanë përthyer. Çdo herë ai i dëboi nga vatra e tij skllavëruesit e huaj, duke ruajtur lirinë dhe dinjitetin e vet. Duke folur për lufrat e popullit shqiptar në të kaluarën, autori nënvizon idenë se frytet e tij kanë shkuar gjithënjë në "xhepat e politikanëve dhe aventurierëve përfitonjës", të cilët përpiqeshin "kush e kush t'i hypte popullit më mirë në kurriz". "Populli ynë i vogël, po kudoherë i munduar, i shtypur dhe i shfrytëzuar prej çdo regjimi, kërkonte — thuhet në një artikull — të shkundej njëherë e përgjithmonë nga gjithë këto mjerime, kërkonte një rrugëdalje nga qorrsokakët, ku e kishin futur politikanët aventurierë dhe shfrytëzuesit e çdo lloji".¹⁾

Në artikujt e E. Hoxhës zbulohen në mënyrë të thellë veçoritë e zhvillimit të luftës së popullit shqiptar kundra pushtuesve fashistë. Në fillim nuk qe e lehtë thotë autori, të mposhtej qëndrimi fatalist dhe mosbesimi në vet-vete, që përfundimet e hidhura të përpjekjeve popullore kishin rrënjësor në shpirtin e njerëzve. Vështirësitë vinin dhe nga fakti, se populli, "megjithëse e urrente me tërë shpirt shkelësin, nuk ishte akoma në gjendje të kuptonte si duhej taktikën e armikut e të kollonës së pestë, sepse s'kishte një edukatë të mjaftë politike". Në artikujt me këtë temë si pe i bardhë kalonte ideja se kësaj here populli shqiptar do t'i kapërcente të gjitha pengesat në rrugën e fitimit të lirisë së vet politike dhe shoqërore.

E. Hoxha ungrit me aspërsi dhe gjithë zemërim kundra grabitjes së pasurive të vendit, të djersës e të mundit të bujkuve shqiptar prej shoqërive të posaçme, të krijuara prej fashistëve dhe veglave të tyre ("Krijimi i shoqërisë anonime bujqësore", "Shoqëria SASTEB") — kusari kolosale e organizuar nga Merlika e fashizmi për të rrëmbyer kafshatën e gojës të fakir-fukarasë". Në artikullin e dytë nëpërmjet faktesh e të dhënash statistikore zbulohet qartë prapaskena e kësaj vjedhje të organizuar në shkallë të gjerë, tregohen pasojat shkatërruese të veprimtarisë së SASTEB-it në ekonominë e vendit, stigmatizohet bashkëpunimi i krerëve fashistë në Shqipëri, i Jakomonit me shokë, me tradhëtarët dhe spekulatorët e mëdhenj vendas, me Merlikajt, Vrionasit etj. për të rjepur popullin dhe shtuar kapitalet e tyre. SASTEB-in autori e quan "Shoqëri gangsterash" që ka hedhur rrjetin e vet në Shqipëri si bandat e "Al Kapones".

E. Hoxha i luftoi forcat reaksionare, që s'lanë gur pa luajtur që populli të mos u shpëtonte nga duart. Me forcë dërmuese në shkrimet e tij demaskohet sidomos agjenti i vjetër i fashizmit, një nga figurat më të zeza të jetës politike shqiptare, Mustafa Kruja. Duke përdorur të dhëna biografike dhe fakte nga jeta politike bashkëkohëse dhe sidomos duke folur për manevrat e tija mashtruese, autori jep një portret satirik mjaft të goditur të tradhëtarit. Thelbi i tij zbulohet përmes epitetesh dhe metaforash të ngjeshura nga ana emocionale: ai thirret "spiuin i vjetër", "bimbash i fashizmit", "korb i zi", "i matur me lireta", "kryeagjent", etj. Me forcë të veçantë u goditën veçanërisht orvajtjet demagogjike të Mustafa Krujës për ta hequr vehten si "nacionalist". Këtë manevër autori e zbulon me shprehimësi, duke shfrytëzuar mjetin e afrimit të dy nocioneve ekstreme: "tradhëtarin doli në meshën

1) E. Hoxha, "Nga Kongresi i Përmetit në çlirimin e plotë të Shqipërisë", "Bashkimi", 1944, korrik, Numur special, f. 1.

2) E. Hoxha; "Vendimet historike të mbledhjes së II të K.A.N.Ç.-it, mbajtur në Berat, "Bashkimi"; 1944, nëntor. Numur i posaçëm, f. 2.

e nacionalizmës". Në artikullin e fortë "Fjalimi i trathtarit, mbajtur më 22 nëndor 1942" përpjekjet e M. Krujës krahasoheshin me veprimet e shkathta të prestigjatorit, i cili ia fsheh publikut sahatin e vet, duke thënë se e humbi. Ashtu bënte edhe M. Kruja në fjalimet e tija. Për të gënjyer popullin ai nuk e përmend asnjëherë fjalën "fashizëm" në fjalimin e tij, megjithëse i shërbente po me aq besnikëri si përpara.

Fshikulli satirik i autorit rreh pa mëshirë edhe krerët e tjerë të reaksionit, si Lumo Skendon, Mehdi bej Frashërin. Këta "zotërinjtë kulltuqeve dhe të kompromiseve pasi ishin përlayer në çdo punë të qelbur", shpejtojnë të "përvehtësojnë luftën e djalërisë shqiptare" dhe t'i vënë mbi krye "regjime shtypëse dhe klika hajdutësh e tradhtarësh". "I ka gënjyer mendja të gjithë ata, që besojnë ndryshe, — shkruante autori — mjerë ata që s'po shohin, se sa përpara është populli ynë, që s'po kuptojnë hala, se s'gënjehet kollaj ky popull shqiptar i vitit 1943 me dëngla dhe me fjalë bombastike, që mbulojnë regjime tmerri e urre, mjerë ata që s'kanë kuptuar shpirtin e kësaj djalërie heroike dhe hovin e saj mbinjerëzor. Këta njerëz janë prapa, këta njerëz janë të destinuar të zhduken se nuk rrojnë me kohën".¹⁾

Shumë artikuj të E. Hoxhës kanë thurjen e një fjale oratorike: në krye duket, se autori i drejtohet auditorit, pastaj paraqitet ideja, e cila më të shumtën e rasteve zhvillohet në frymë polemike, duke u nxjerrë në shesh herë njera anë, herë ana tjetër e problemit, dhe pastaj vjen përmbyllja. Për publicistikën e E. Hoxhës janë karakteristike intonacionet e ngritura. Për Shqipërinë e robëruar, për qëndresën burrërore të popullit, për aktin e lartë të martirëve të atdheut autori flet me zjarr, gjithë emocion. Ndonjëherë shtjellimi i idesë bëhet në plan satirik. Kjo ngjiste atëhere, kur i zëmëruar prej akteve revoltuese të mashtrimit dhe të grabitjes së organizuar të pasurive të vendit prej jerarkëve fashistë dhe veglave të tyre, autori rrëmbente kamxhikun e ironisë dhe të sarkazmës për të goditur pa mëshirë. Në vend të artikullit publicistik atëherë doli fejtun ose pamflet satirik.

Krahas epitetëve dhe metaforëve të zgjedhura nga pikëpamja emocionale, autori përdor edhe ironinë, antitezën, apostrofen dhe ndonjëherë edhe parodinë. Autori shfrytëzoi me mjeshtëri fjalë të sferave të ndryshme leksikore - stilistikore.

Publicist tjetër i shquar i luftës Nacional Çlirimtare qe Nako Spiro. Në ato vite ai e çfaqte vehtën si mjeshtër i pamfletit politik. Objekt i satirës së N. Spiros janë politikanët e kalbur, miq të luogotenencës fashiste, agjentët e kollonës së pestë dhe njerëzit e tyre, që përhapnin poshtë e lartë fjalë për të diskredituar luftën e popullit shqiptar, "tradhhtarët", "dallaveraxhinjtë", "intranitët profesionistë", që "kanë hy në të gjitha kombinacionet politike", "intelektualët e kalbur", "reaksonarët fanatikë", "arrivistat e rinj në fushën e politikës", që duke i hequr vehtes një bojë nacionaliste, bëjnë çmos për t'i vjedhë lirinë" popullit dhe për të sunduar mbi të, si në të kaluarën, "kalemçinjtë e shitur", që nxinin fletushkat antipopullore të komandës gjermane dhe të organizatës tradhëtare.

Në themel të mjeteve artistike kushtuar demaskimit të armikut qëndron ballafaqimi i hapur i fakteve, kontrasti në mes asaj që armiqt thonë dhe veprave të tyre.

Në artikujt e vet N. Spiro zbuloi në mënyrë të shkëlqyer fytyrën e Ballit Kombëtar. Për origjinën e Ballit, për elementët politikë dhe shoqëror, që e përbënin dhe për qëllimet që kjo organizatë ndiqte, ai flet me krahasime dhe epite të gjalla. Në këtë organizatë, shkruan autori, "prehen" "patrio-

1) E. Hoxha, "Lodrat e nazistëve okupatorë", 1943, Bu letini i Bashkimit.

tët e çerekut t'ërës së fundit" që "rrijshin në prehën të luogotenencës"¹). "njerëzit ma antipopullorë, ma antidemokratë të Shqipërisë, njerëzit qi kanë qenë kurdoherë kundra përpjekjeve dhe luftave çlirimtare të popullit tonë.. dhe ajo qi asht ma keq i japin tonin politikës së tij"²). "Balli, — lexojmë në një artikull tjetër — i dha mundësi të gjithë reaksionarëve të lidhë me okupatorin, që të fshiheshin edhe ata në një organizatë politike, nga ku do të vazhdojshin në maskën e patriotizmit luftën e tyre antipatriotike"³.

Autori nxjerr qartë në pah mospërputhjen në mes të dukjes së jashtëme dhe esencës, në mes të pretendimeve të ballistëve dhe brendisë së veprës së tyre. Qysh kur u krijua, por në mënyrë të veçantë pas kapitullimit të Italisë, kjo organizatë nisi të çirret me të madhe, se është gjakosur gjoja me pushtuesit italianë për Shqipërinë, se ka dhënë sakrificat të shumta për çlirimin e vendit. N. Spiro i përqesh këto pretendime me një sarkazëm dërmonjëse, duke treguar me fakte të kundërtën: "Balli kombëtar s'ka çlirue akoma një katund". Qëllimi i Ballit, shkruan aктору, është që me "një pushkë këtu, një pushkë aty. . . me kalue më parë fallso në histori"⁴).

Në artikujt e fortë, dërmonjës, të N. Spiros, paraqitet me ngjyra shumë të gjalla roli tradhëtar i Ballit Kombëtar sidomos gjatë pushtimit nazist, bashkëpunimi i tij me ushtritë hitleriane për të mbytur me gjak dhe hekur lëvizjen e popullit shqiptar. Me zëmërim flitet për djegjet, plaçkitjet, raprezaljet dhe terrorin e çetave balliste në fshatra dhe qytete, për arrestimet, torturat dhe masakrat që komandantët e Ballit përdornin për të mposhtur rininë shqiptare ("Kriminelët", "Akoma dy fjalë për Ballin", "Çështje të ditës", prill, 1944). "Kriminelët ma në za hynë në Ball dhe n'emër të nacionalizmit me bekimin e Lumo Skendos filluen të tmerrojnë fshatrat e t'ua bajnë prita partizanëve. . .", — shkruante autori.⁵)

Temë tjetër e rëndësishme e publicistikës së N. Spiros ishte çështja e rinisë, problemet e jetës dhe të luftës së saj kundra pushtuesit fashist. Në këto artikuj tingëlloi me forcë ideja e aspiratave të pastra dhe fisnike të rinisë shqiptare, e cila u hodhë në luftë kundra sunduesve fashistë, e frymëzuar nga dashuria e thellë dhe besnikëria karshi popullit. Këtë rini autori e mbron nga shpifjet e propagandës fashiste dhe të agjentëve të kollonës V, nga "miqt" e luogotenencës, këta "zotërinj me bark dhe ofiqe", që në të kaluarën "ishin mësuar të shisnin Shqipërinë në tregun e politikës ndërkombëtare" dhe tani nuk u "leverdis", që rinia kish rrokur pushkën dhe luftonte, nga "kompromisaxhinjtë që orvateshin ta diskreditonin luftën e saj, si "punë axhamijsh". Këtyre njerëzve autori u dha një përgjigje të ashpër në artikullin "Përgjigjemi", botuar në "Kushtrimin e lirisë" në numrin e marsit të vitit 1943, i cili pati jehonë të gjerë në shtresat e rinisë. Kontrasti satirik ishte në këtë shkrim mjeti që nxori në shesh qartë fytyrën e vërtetë të këtyre "miqve" të rinisë. Në fillim parodizohen parrullat e kollonës V dhe pastaj ipet karakteristika politike, morale e psikologjike e njerëzve që i përhapnin këto shpifje kundra lëvizjes së rinisë. Autori qëllon me pendën e vet pa mëshirë dhe saktë. Luftën, sakrificat, idealet e rinisë N. Spiro i mprojtë me energji sidomos në vitet e pushtimit hitlerian, kur tradhëtarët, duke nisur me Ballin Kombëtar e duke mbaruar me Legalitetin u hodhën për t'i

1) N. Spiro, "Çështje të ditës", "Zëri i popullit", 1943, shtator. Nr. 20, f. 1

2) N. Spiro, "Mbi bashkimin e popullit shqiptar", "Zëri i Popullit", 1943, shtator. Numur special, f. 1

3) N. Spiro, "Akoma edhe dy fjalë për Ballin", Botim i posaçëm i "Zërit të Popullit", 1944, prill, f. 7

4) N. Spiro, Çështje të ditës, "Zëri i Popullit", 1943, tetor, Nr. 21, f. 2

5) N. Spiro, "Akoma edhe dy fjalë për Ballin". Botim i posaçëm i "Zërit të Popullit", 1944, prill, f. 7

rrembyer popullit fitoren nga duart ("Rruga jonë", "Kur po del numuri i parë"). Kur rinija luftonte, bënte sakrifica, tradhëtarët ishin "në prehën t'Imperos", — shkruante autori. Ai i paralajmëronte tradhëtarët të mos i gënjejë mëndja, se rinia lufton për 'ta. "Na marshojmë drejt së nesërme, plot dritë, tue i kthye krahët një herë përgjithmonë të kaluemes së errët¹⁾".

Pamfletat e N. Spiros çqohen nga trajtimi i qartë e konkret i problemeve; ato janë të shkurtër dhe kapin çështjet në mënyrë mjaft origjinale. Zakonisht në themel të tyre qëndron një fakt konkret nga jeta politike e ditës ose ndonjë parrullë e propagandës armike. Për kompozicionin e shumë prej tyre është karakteristik paraqitja në fillim e ndonjë ngjarje ose përkrahimi i ndonjë fakti dhe pastaj vjen analiza. Në shkrimet e N. Spiros gjejmë shpesh epitetet e forta, ironinë, sarkazmën, parodinë dhe kontrastin. Epitetet e N. Spiros janë të qarta dhe në përgjithësi të mbushur me fuqi të madhe demaskuese.

Në vitet e luftës Nacional Çlirimtare një veprimtari publicistikë dhe letrare pak a shumë të gjerë për kushtet e asaj kohe zhvilloi Sh. Musaraj. Në "Kushtrimin e lirisë", "Zërin e popullit" dhe në Buletinin e "Zërit të popullit" ai botoi një mori artikujsh propagandistikë, fejtoneesh politike, skicash historiko-revolucionare, reportazhesh dhe pamfletash, të cilat përbëjnë një fond të çmueshëm të letërsisë së viteve të luftës. Ato dhanë një kontribut të madh për edukimin patriotik dhe revolucionar të masave të popullit dhe të rinisë.

Në shkrimet e veta Sh. Musaraj zbuloi fytyrën e vërtetë të pushtuesve fashistë. Autori e quan fashizmin "qelbërsirë të shekullit XX". Duke folur, si gjatë luftës së dytë botërore fashizmit i ra boja dhe njerëzit kudo në Evropë e kuptuan shpejt ose ç'përfaqëson, ai shkruante, se atij "as qentë s'i afrohen, jo njerëzit". Sh. Musaraj zbuloi parrullat mashtruese të propagandës armike dhe nxori në shesh fytyrën e vërtetë të fashizmit si armik të Shqipërisë e të popullit shqiptar. Në "Mizoritë e fashizmit në Pezë", "Armiku s'ngopet me gjak", "Në Pezë armiqt hanë dru", "Marifetet e fashizmit", etj. autori flet me urrejtje dhe zëmërim për djegjet dhe plaçkitjet e trupave fashiste në fshatrat e Pezës, dhe të krahinës së Kosovës, për mizoritë e tyre kundra popullsisë së paarmatosur, stigmatizuar me forcë fytyrën prej gjakpirësi të fashizmit. "Armiku, — shkruante autori, — e ndjen thellë dackën e madhe që pasoi në Stalingrad. . . dhe po nxitohet të mbushë radhët e boshatisura me njerëz bote, po nuk i ze syri që t'i rrembejë armët dhe t'i vejë në ndihmë fashizmit. Dhe atëhere ç'ngjet? Ajo që ngjet zakonisht me bishën e plagosur. Një natë të tmerrshme dimri bisha fashiste armatos me armët e veta disa qindra mercenarë dhe i lëshon atje ku rezistenca është më e vogël²⁾". Në shkrimin "Armiku s'ngopet me gjak" shkrimtari e quante fashizmin "armik burracak", që "kërkon t'i masë armët me atë aqë s'ka armë".

Gjithë përbuzje dhe neveri flet autori për veglat e fashizmit, të cilat i quan "gala që mbajnë kombësi shqiptare". Në artikujt "Zëri i Vlorës", "Dy fjalë Mustafa Krujës", "Mustafa Kruja mësheh diellin me shoshë", etj. autori zbulon fytyrën antikombëtare dhe reaksionare të agjentit të vjetër të fashizmit italian. Ai cilësohet me epitete që nxjerrin qartë në shesh thelbin e jetës dhe të veprës së M. Krujës: "gogol i ndyrë", "kryepërgjegjës i mijra krimeve në kurritz të popullit shqiptar", etj.

Sh. Musaraj zotëronte në mënyrë të përsosur humorin dhe sarkazmën e popullit. Shkrimet e tij të luftës janë me plot fjalë dhe shprehje humoristike nga e folura e përditshme e njerëzve të thjeshtë. Me 'to ai godet ashpër pseu-

1) N. Spiro, "Rruga jonë", Fletë të "Kushtrimit të lirisë", 1943, dhjetor, Nr. 5, f. 4

2) Sh. Musaraj, "Marifete nga të fashizmit", "Kushtrimi i lirisë", 1943, prill, Nr. 9 f. 15.

dopatriotët, politikanët e vjetër profesionistë, që ishin mësuar ta mbanin veten si "prijat" të popullit. Këta njerëz, të cilët thonin, se populli shqiptar mund ta fitojë lirinë e vet edhe pa gjak, por vetëm me dallavera, me ca kompromise "bigim", shkrimtari i quan "qullashë të pallogjikë", "qole të bindur të fashizmit"; "kapedanë të kohës", që mundohen ta mbajnë veten për "nacionalistat me ferman" ("Që thua ti . . .", "Një lloj njerëzish", Edhe një takem të sëmurë", etj). Në artikullin "Kollona e pestë po i tepëron gjynahet" shkrimtari i thotë, se parullat e tyre kanë burimin të kollona e V dhe se këta njerëz në këtë mënyrë përipiqen të pengojnë popullin të kuptojë fashizmin dhe të fitojë me duart e veta lirinë dhe pavarësinë e humbur. ". . . Populli ynë, — thuhet në këtë arkikull, — s'ka më pse t'u vari torbën kapadaive të kollonës së pestë, që po ngjiret së ndjelli andej-këndej parrulla dekurajonjese, parrulla frike, parrulla që fundi fundi s'kanë tjetër burim përveç atij të fashizmit dinak"¹⁾.

Një vend të rëndësishëm jo vetëm në publicistikën e Sh. Musarajt, por në të gjithë letërsinë e luftës Nacional Çlirimtare ze pamfleti "Dje dhe sot". Kjo vepër u shkroi në janar të vitit 1944, në kohën kur i gjithë reaksionin, i grumbulluar dhe i drejtuar prej Gestapos, çirrej, se lufta Nacional Çlirimtare ishte në dëm të Shqipërisë, se gjermanët nuk kanë ardhur "si okupatorë" dhe se "nuk do të përzihen aspak në punët e brëndëshme të vendit". Qëllimi i tyre ishte të ngjallnin hutim dhe konfuzion në popull, ta përganin atë dhe ta largonin nga lufta kundra pushtuesve hitlerianë. Autori demakonq mënyrat e tyre djallëzore, tregon se kush janë njerëzit që bashkëpunojnë me gjermanët kundra popullit shqiptar. Kur kapitulloi Italia fashiste, tradhëtarët e atdheut, "myflizët", shkruante autori, u vërsulë të shpallin independencën që po i falte Adolf Hitleri". Shkrimtari jep një karakteristikë të goditur të kampit të armiqve të popullit, që u vunë në shërbim të padronit të ri. Tani shtjehen si patriotët, shkruan Sh. Musaraj, ata që s'kishin çarë ndonjëherë kokën për fatin e atdheut", mbeturinat e fashizmit italian, që "kishin fshehur në shtëpitë e tyre këmishat e zeza", "duaxhit e çmëndur të nazizmit" që komentoin dikur me entuziazëm nëpër sallat e kafeneve "komunikatat e bujshme të Wermachitt", të cilët thonë se "është detyra kombëtare, që i shtrëngon t'i heqin kapellon ushtrisë gjermane" dhe "Balli Kombëtar, daullja, që mbante avazin në orkestrën e tradhëtarëve". Me gjuhë të mprehtë, plot figura dhe shprehje të gjalla, autori zbulonte qëllimet e vërteta të fushatës demagogjike të shpërthyer nga veglat e Komandës gjermane dhe organizatat tradhëtare, të vëna në shërbim të Gestapos.

Në "Punra pa lezet", "Të dashur djem", "Ne dhe ata", Sh. Musaraj me një humor të lehtë vinte në lojë orvatjet e kota të fashistëve italianë dhe të ballistëve për të penguar luftën e popullit. Zgjimi i masave popullore, ndryshimet e thella që ngjasin në psikologjinë e tyre nën ndikimin e ngjarjeve të përditëshme të lëvizjes për çlirim, lindaj dhe formimi tek "ta i një ndër-gjegje të lartë politike, gjeti pasqyrim tek skicat "Djemt e fshatit", "Në prakun e lirisë", "Nëna e Zijait", "Shtek më shtek me partizanët e divizionit të I S". "Të dashur djem", etj. Skicën "Djemt e fshatit" autori e ka ndërtuar si përshkrim i një vizite në një fshat të Labërisë në janar 1942 dhe në dhjetor po të atij viti. Në pjesën e parë të skicës fshatarët janë nxjerrë të shushatur prej fatkeqësive, që u kanë rënë mbi krye, të shtypur nga varfëria dhe padija, që vuajnë e s'dijnë nga t'ia mbajnë. Kur i takon sërish, shkrimtari i gjen ata

¹⁾ Sh. Musaraj, "Kollona e pestë po i tepëron gjynahet", "Zëri i Popullit", 1943, shkurt; Nr. 13-14, f. 9.

të ndryshuar fare. Lëvizja që kishte nisur kundra të huajve i zgjoi nga pasi viteti ku lëngonin, i ndihmoi të shikojnë qartë dhe me besim jetën, i bëri luftëtarë të patrembur të lirisë. "Milicët e xhandarët ven 'e vinë. Kërkojnë kryengritësit. Po kush ua var trastën. Kryengritës jemi të tërë nashti. S'ka më ujdira me armiq. E kemi kuptuar tej për tej, se ku na pikon shtëpia. Dijmë ta ndajmë të zezën nga e bardha. E varfëra unë, sa e humbur kam qënë!"¹⁾ — thotë një grua plakë labe. Në skicën "Të dashur djem" Sh. Musaraj flet për njerëzit që duke përsëritur parrullat e kollonës së V shajnë luftën e popullit shqiptar kundra zaptontjesve italianë. Shkrimtari e di se luftën e kritikojnë ata që e kanë shtrydhur fshatarin, "ata, që u janë mësuar gjithënjë këmbët në zengji". Ngjarjet në këtë shkrim ipen nëpërmjet të rrëfimit të një fshatari të thjeshtë, brisk nga gjuha, që i janë hapur sytë mbi të vërtetën e jetës. Në shumë skica të Sh. Musarajt dalin të vizatuar në viza të lehta figurat e njerëzve të popullit, të fshatarëve të varfër dhe të partizanëve, del shpirti patriotik dhe vendosmëria e tyre në luftë kundra fashizmit dhe tradhëtarëve të vendit.

"Shtek më shtek me partizanët e divizionit IS" është një tok vizatimesh dhe skenash të shkurtëra realiste nga marshimi i partizanëve të këtij formacioni të Ushtrisë N. Çl. për çlirimin e Shqipërisë së Veriut në verë 1944. Në këtë libër, që u botua në tipografi po këtë vit, shkrimtari jep me dy-tre ngjyra figurat e partizanëve trima, që nuk i lodh as rruga e gjatë as edhe privacionet e shumta të jetës në male. Luftëtarët e lirisë jetojnë me një dëshirë, me një mendim: të dërmojnë armikun dhe të çlirojnë sa më parë atdheun. Syri i mprehtë i autorit dikton ato elemente të reja që lufta Nacional Çlirimtare ngjalli dhe zhvilloi në jetën e popullit, në karakterin e njerëzve: thjeshtësinë, frymën e solidaritetit, ndjenjën e madhe të dashurisë që e shtyn tejetrin të linte kokën për shokun, shpirtin heroik, ndjenjën e përgjegjësisë ndaj popullit, gatishmërinë për sakrificën më supreme për idetë e partisë. "Shtek me shtek me partizanët e divizionit IS" përshkohet nga ideja e karakterit të thellë popullor dhe çlirimtar të luftës që u bë kundra skllavëruesve italianë.

Publicistika e Sh. Musarajt shquhet për stilin e rrjedhshëm dhe tërheqës, për shkurtësinë dhe ngjyrat e gjalla, me të cilat përshkruhen njerëzit dhe ngjarjet e jetës, për gjuhën e pasur me fjalë dhe shprehje të bukura popullore.

III

Hovin e vet më të madh letërsia revolucionare e njohu në vitet 1941-1944, kur Partia Komuniste i ndriçoi popullit shqiptar udhën e shpëtimit nga skllavëria e huaj. Një rrethanë shumë e favorëshme që i dha dorë zhvillimit të saj që shtypi i partisë dhe ai antifashist.

Për letërsinë shqipe, që lindi në shtypin ilegal, që karakteristik lërimi i poezisë. Kryesisht kjo që poezi patriotike, që i këndoi qëndresës heroike të masave kundra sundesve të huaj. Vetë rrethanat në të cilat u rrit dhe kërkesat, që i paraqiste asaj jeta, përcaktuan karakterin publicistik — agjitativ, prirjen e saj drejt figurave romantike dhe mjeteve patetike të shprehjes, përdorimin e një leksiku të ngritur solemn-heroik, lidhjen e ngushtë me traditat e folklorit.

Lërimi më tepër i llojeve poetike shpjegohet me kushtet, në të cilat u zhvillua letërsia revolucionare ilegale. Kur ngjarjet rrokulliseshin me shpej-

1) Sh. Musaraj, "Djemt'e fshatit", Tregim, "Kushtrimi i lirisë", 1943, mars, Nr. 8; f. 14

tësi të madhe njera pas tjetrës dhe detyra kryesore ishte stigmatizimi i armikut aty për aty menjëherë me armën e fjalës, poezia ishte lloji letrar, që i përgjigjej më mirë këtij qëllimi.

* * *

Gjatë lëvizjes Nacional Çlirimtare përhapje të madhe morën këngët revolucionare. Kënga që forma poetike më e përshtatëshme për të pasqyruar entuziazmin patriotik, që rrëmbeu masat e gjëra në këto vite; në këngën gjeti shkrim zëmërata e shenjtë popullore kundra fashizmit italian dhe veglave të tij të urryera. Këngët i kënduan sakrificës supreme të komunistëve dhe të partizanëve për çlirimin e Shqipërisë, ato shprehën gëzimin e përgjithshëm për hovin e madh që mori lufta me formimin e brigadave dhe të divizioneve të ushtrisë Nacional Çlirimtare.

Veprat e para të letërsisë së re që lindi gjatë luftës kundra pushtuesve nazi-fashistë qenë përkthimet e këngëve revolucionare dhe sovjetike, si "Internacionalja", "Kominterni", "Barrikadat proletare", "Flamuri i kuq", "Kënga e partizanëve sovjetikë", "Ushtria e Kuqe" ("Fusha, ju fusha"), "Fronti popullor", "Pararoja" etj. Këto këngë ishin shumë popullore në kohën e luftës kundra fashizmit. Ato kumbuan në demonstratat dhe mbledhjet e fshehta, në burgjet dhe në malet e lira, ku vepronin çetat partizane. Brenda revolucionare, motivi i protestës kundra shtypjes shoqërore që përmbanin, i shkonin karakterit çlirimtar të luftës që bënin masat popullore. Veçanërisht i madh që roli i tyre në fillim, kur qëndresa popullore ishte në hapat e saja të para. Në vitet, ku në të gjithë vendin kishte pllakosur sundimi i zi fashist, këngët revolucionare dhe sovjetike me idetë e tyre kryengritëse, intonacionet thirrëse për luftë dhe ritme prej marshi kallnin në ndërgjegjen e njerëzve frymën revolucionare, ngjallnin shpirtin e protestës dhe të qëndresës, i edukonin masat me besime në fitoren mbi armiqtë dhe me gatishmërinë për sakrificë.

Rëndësia e këngëve nuk kufizohet me ndikimin e madh edukativ që ushtruan tek njerëzit, duke i përgatitur ata shpirtërisht për përlëshjen e afërt me pushtuesit e huaj. Ato luajtën një rol të madh edhe si modele të njëletërsie të re në shërbim të masave punonjëse. Shpejt në shembullin e tyre dolën një varg këngësh origjinale me përmbajtje revolucionare, të cilat u përhapën e u kënduan nga populli dhe veçanërisht prej të rinjve.

Mjaft popullore u bënë sidomos këngët e F. Gjatës, i cili erdhi në letërsi në këto vite. Në "Kushtrimi", "Kënga e rinisë", "Hakmarrje", "Plaku dhe i riu", "Ato maja ripa ripa", "Kudo malet buçasin" poeti i ri transmetoi romantikën e luftës çlirimtare, vrullin e ndjenjave, që mbushnin zemrat e të rinjve antifashistë në ato çaste të rëndësishme, kur populli ishte sulur në luftë me armiqtë e vet. Te kënga "Kushtrimi" mbizotëron toni epik. Autori flet për entuziazmin luftarak që ka përfshirë të gjithë vendin. Punëtorët dhe të rinjtë kanë hedhur armët supeve e kanë marrë malin. Çdo patriot i vërtetë, thotë poeti, duhet t'i përgjigjet detyrës karshi atdheut dhe të bashkohet me luftëtarët e lirisë:

La parmëndën sot fshatari,
S'mbeti burrë në shtëpi.
Kush ka zemër shqiptari
Del sot malit për liri.
Zëri i pushkës me furi
Po buçet sot anëmbanë

Se luftojnë për liri
Shokët trima partizanë.¹⁾

Qëllimit të vet, — të ndezë zemrat e njerëzve me dashurinë e flaktë për atdhe, — F. Gjata ia arrin nëpërmjet të përdorimit të një leksikut, që krijon një atmosferë heroike: "gjokset djaloshare", "ngrihen grushte", "zëri i pushkës me furi buçet sot anembanë", "turren gjithë si rrufeja", "derdhet gjaku në beteja", etj. Këtë përshtypje e përforcon ritmi energjik, ishpejtë i këngës. Për nga ideja dhe karakteri epik pranë "Kushtrimit" rri kënga "Ato maja ripa-ripa". Edhe këtu poeti synon të japë pamjen e përgjithëshme të vendit, që është ngritur në luftë vendimtare me armiqtë. Është kjo një pamje heroike legjendare. Malet e Shqipërisë gjëmojnë nga sulmet e partizanëve, që "luftojnë" dhe "marrin hak". Frazat e gjata, që zënë pothuaj të gjithë strofën, e shtojnë frymën paraqitëse, narrative. Dymbëdhjetërokëshi i jep rrëfimit një ritëm të ngadaltë. "Kënga e rinisë" ka ndërtim tjetër. Ajo është ngritur mbi intonacione thirrëse dhe agjitative. F. Gjata i drejtohet rinisë me një fjalë të zjarretë e plot patetizëm, ku i njofton, se atdheun po e "çfili" fashisti i zi. Rinia duhet të ngrihet dhe të rrokë pushkën. Poeti i kujton të rinjve traditat e lavdishme liridashëse të popullit shqiptar ("lufto armiqtë, lufto barbarët, me trimëri pors shqiptarët"). Edhe te kënga "Plaku dhe i riu" F. Gjata shprehu vullin patriotik, që ka rrembyer rininë e vendit. Ideja është zbuluar nëpërmjet të formës dialogjike. Plaku është ruajtësi i traditave patriotike të së kaluarës. Te ai është nxjerrë brezi i luftëtarëve të vjetër, që me gjakun e tyre siguruan lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Në kraharorin e tij qëndron i gjallë dhe i pa shuar shpirti luftarak i shqiptarit. Plaku i jep të riut, para se ky të shkojë në mal, uratën. Motivi i uratës për në luftë nuk është i ri në letërsinë shqipe. Atë e gjejmë edhe në këngët patriotike të Rilindjes Kombëtare ("Uratë për liri" e M. Gramenos). Në rrethanat e luftës Nacional Çlirimtare, e cila synonte jo vetëm të dëbonte të huajt, por njëherazi ishte një revolucion popullor, drejtuar kundra klasave të vjetra sunduese, ky motiv fitoi një kumbim më të gjërë. Plaku e fton të riun të luftojë:

Që të ketë në Shqipëri
Bukë, paqë dhe liri²⁾

Me përhapjen dhe forcimin e lëvizjes partizane lindin këngë të reja, të cilat sollën me vete atmosferën luftarake të kohës, dashurinë e madhe të partizanëve dhe të rinjve për popullin, besnikërinë e tyre të palëkundëshme ndaj idealit, që ia kanë kushtuar jetën ("Shqiponjat partizane" të K. Jakovës, "Kushtrimi", "Buçasin malet si gjemim", "Partizani n'luftë po shkonte", "Luft' e lirisë na thërret", "Malli i nënës" "O ju të rinj edhe të reja", "Mjaft në robëri", "Shoqes", etj).

Lufta kundra pushtuesve të huaj që e rëndë, plot vështirësi dhe sakrificë. Spiunët dhe mercenarët e shitur tek fashistët ndiqnin këmba këmbës luftëtarët e lirisë; shumë shokë u burgosën ose u vranë. Të tjerë ranë në përpjekje me armiqtë në qytete dhe në mal. Duke u nisur nga raste a ndodhi konkrete, poetët iu drejtuan figurës së komunistit, të partizanit dhe të njeriut të popullit, që dha jetën në emër të idesë së çlirimit të atdheut. Në të gjeti pasqyrim pikëllimi për shokun e rëndë dhe ngrihet lart akti suprem heroik. Për këngët kushtuar dëshmorëve është karakteristike përmbajtje burrërore e hidhërimit. Ato i çquan jo dëshpërimi që s'ka të qetësuar, por motivi i hak-

1) F. Gjata, "Këngët e maleve", Tiranë, 1954, f. 23

2) Po aty, f. 24

marrjes për gjakun e derdhur. Bashkëluftëtarët betohen se do të marrin hak pa mëshirë mbi armiqtë dhe do ta çojnë në vend amanetin e dëshmorëve. Ndër këto këngë më të përmendura ishin "Kënga e tre heronjve të Shkodrës" e K. Jakovës, "Kanga e Asim Zenelit" e Q. Buxhelit, "Dëshmorëve të kombit" e A. Varfit, "Dalngadal po vjen behari", "Nëna" ("Ku kam vajzën, ku kam djalin"), "Shokut Qemal Stafa", "Kënga e Mine Pezës", etj.

Në "Kangën e tre heronjve të Shkodrës" u pasqyrua fryma heroike e luftës Nacional Çlirimtare, trimëria dhe burrësia, që komunistët e treguan në luftë kundra fashistëve. Këngën e vet K. Jakova e thuri, duke marrë mjetet teknike prej gurrës popullore. "Kanga e tre herojve të Shkodrës" ka huajtur shumë prej poetikës së rapsodive. Sikurse në këngët epike legjendare në të elementet e përshkrimit dhe të rrëfimit janë reduktuar në minimum. Veprimi zhvillohet shkurt; dialogu zen vendin kryesor në këngë dhe shërben si mjet për t'u njohur me personazhet. Heronjt, fytyra e tyre morale dhe shpirtërore, na çfaqen nëpërmjet të fjalëve, që ata mbajnë, kur marrin vesh, se ishin të rrethuar dhe e kuptuan, se kishte ardhur çasti më i rëndësishëm i jetës së tyre. Me pamjen e tyre të patrembur dhe konceptin burrëror të jetës, tre heronjt, na kujtojnë kreshnikët e këngëve legjendare popullore. Komunistët s'e bëjnë veten para vdekjes, që ka hedhur hijen e saj mbi shtëpinë, ku janë rrethuar.

Ç'ka po thot' Kadija:
— Flak le t'kallet shpija,
Ta marr vesh Shqipnija
Se na i dalim zot.

Ç'ka po thot' Perlati
— Burra bahi gati,
Se ka ardh sahati,
T'hujt me i dhan barot.¹⁾

Me zgjerimin e luftës së armatosur kundra fashistëve dhe formimin e brigadave e të divizioneve të para dolën hymnet dhe marshet partizane ("Hymni i Ushtrisë Nacional Çlirimtare" i A. Varfit, "Marshi i korparmatës së I S" dhe "Marshi i divizionit I S" të Sh. Musarajt, "Marshi i Brigadës I S" i Mehmet Shehut, etj.). Në 'to u çfaq gëzimi i popullit se lindi Ushtria Nacional Çlirimtare. Ajo thirret "ushtri çlirimtare", "shpresë e madhe", që shkrin hekur mbi armiqtë dhe i jep popullit liri".

Marshet dhe hymnet partizane janë të mbushur me vullin luftarak, që karakterizonte ato vite, me ndjenjat e optimizmit dhe të vendosmërisë, që çquante luftëtarët e popullit, me sigurinë në çlirimin e afërt të atdheut. Në përputhje me këtë brendi janë intonacionet energjike, leksiku me frymë patetike heroike, ritmi i tyre plot vull dhe forcë.

Në këtë periudhë figurë aktive e letërsisë revolucionare qe Sh. Musaraj; ai cili dha një kontribut të çmuar për themelimin dhe afirmimin e saj.

Gjatë luftës përveç aktivitetit të gjerë publicistik që zhvilloi, ai shkroi një tok vjershash me motiv patriotik e satirik. Krijimi i tij më i çquar në këmbë e poezisë është pamfleti në vargje "Epopeja e Ballit Kombëtar". Kjo vepër lindi nga problemet politike të kohës dhe pati rëndësi të madhe aktuale. Me pushtimin nazist çështja e demaskimit të demagogjisë së Ballit Kombëtar, e nxjerrjes në pah të tradhëtisë së tij ishte problem i një rëndësie politike të dorës së parë. Pa dyshim se një punë e madhe ishte bërë dhe masat e popu-

1) K. Jakova, "Herojt e Vigut" (poemë) dhe vjersha e këngë të tjera, Tiranë, 1953: f. 47.

ilit e shihnin qartë fytyrën e vërtetë të kësaj organizate. Propaganda e partisë me trakte dhe me anë të buletineve të "Zërit të Popullit" ia kishte hequr petat demagogjisë pseudonacionaliste të Ballit. Kësaj teme vetë Sh.Musaraj i kishte kushtuar pamfletin politik "Dje dhe sot". Por dilte nevoja për një vepër, që ta bënte këtë gjë në një formë tërheqëse dhe të kuptueshme, lypsej një vepër letrare, që të mund të kapej dhe të mësohej lehtë prej masës së lexuesve, të lidhur me lëvizjen, dhe sidomos prej të rinjve. Për këtë qëllim drejtuesit e organizatës së rinisë u drejtuan Sh.Musarajt, i cili në atë kohë qëndronte ilegal në Tiranë, me lutje t'u shkruante, siç e thotë poeti në kujtimet e veta "një vjershë humoristike, që të vinte në lojë Ballin Kombëtar") Kështu lindi "Epopeja e Ballit Kombëtar".

Vepra nuk ka ndonjë subjekt të lidhur. Idenë e vet poeti e zbulon, duke treguar historinë e organizatës së Ballit Kombëtar, thelbin e fjalëve dhe të veprave të saja që nga kapitullimi Italisë dhe ardhja e pushtesve gjermano-nazistë e deri në prakun e çlirimit të vendit prej ushtrisë Nacional Çlirimtare. Themelin e veprës e formojnë disa episode dhe skena, që lidhen në mes tyre pjesërisht logjikisht e pjesërisht nga ana kronologjike. Për punët e ballistëve në këtë periudhë autori rrëfen me një ton të hollë ironik. Ballistët janë paraqitur në formë karikature, sharxhi. Të karakterizuara janë edhe fjalët e sjellja e tyre.

Më imtësira të mprehta e të goditura satirike poeti dha hutimin dhe pë-shtjellimin që i kapi ballistët në çastin, kur ra Musolini dhe u dukën të qarta shenjat e kapitullimit të Italisë. Të alarmuar nga rrokullisja e papritur e ngjarjeve, që u prishi planet, ballistët turren të shpëtojnë nga katastrofa, që u kanoset si bashkëpunëtorë të italianëve dhe të ruajnë atë prestigj të pakët që u ka mbetur.

U mbyt gjemija
Me federalë,
O burra, shpejto
Kush mund të dalë

S'ka më Parian
Në Real Palazzo,
As Kol Biban
As sig. Dalmazzo.

Me kapitullimin e Italisë dilte çështja e pushtetit. Balli Kombëtar, qysh në fillim kur u formua, pati si objektiv kryesor të mos lerë masat popullore që vijnë në fuqi. Në situatën e re që u krijua, ballistët marrin masat për të shtënë në duart e tyre drejtimin e vendit. Për këtë qëllim ata çirren poshtë e përpjetë se janë patriotë, se gjithënjë kanë luftuar për Shqipërinë dhe për t'u mbushur mendjen botës kurdisën së fundi edhe vajtjen në "mal". Duke parodizuar me mjeshteri tonin emfatik dhe frazat e bukura pseudopatriotike të krerëve të Ballit Kombëtar, poeti ka arritur fort bukur të verë në lojë falsitetin e parrullave të ballistëve, demagogjinë e tyre:

Flet Ali beu
Luft' për Atdhenë!
Se sot Atdheu
Pret shumë nga ne.

Na vlon ndër deje
 Gjak shqipëtar
 S'durojmë kurrë
 Zgjedhë barbari.

Figurat e krerëve të Mit'hat bej Frashërit, Ali bej Këlcyrës, etj. janë nxjerrë si në karikaturë. Duke i nxjerrë me pasionin e tyre për të mbajtur vend e pa vend fjalime plot pompë për atdhe, autori tallet me pretendimin e tyre për ta hequr veten si njerëz, që historia u ka caktuar misionin e lartë të shpëtimit të Shqipërisë.

Efekti satirik në pjesën e parë të veprës krijohet nga kontrasti në mes të fjalëve të bukura që thonë për Shqipëri ballistët dhe veprave të tyre. Tamam ata njerëz, që s'kanë hedhur asnjë pushkë kundra pushtimit fashist, por kanë qenë gjer dje në kompromis ose bashkëpunëtorë të tij na çfaqen tani që ra fashizmi, sikur kanë qenë kundërshtarë të tij, të ndjekur prej tij. Për të treguar karakterin qesharak të këtyre pretendimeve, poeti ve të flasi të parin Ali bej Këlcyrën, njeriu që firmosi protokollin, në bazë të të cilit Balli Kombëtar angazhohej përpara Komandës së lartë italiane t'i ipte të gjithë ndihmën e vet për të shtypur lëvizjen për çlirim të popullit shqiptar.

Duke zhvilluar idenë e vet, Sh. Musaraj përpiqet ta demaskojë gjer në fund lojën e Ballit me fjalë patriotike. Edhe pasi dalin në mal, ballistët s'bëjnë tjetër veçse ia shtrojnë drekë e darkë me raki dhe mish të pjekur ndër miqtë e tyre. Tërë pjesën e parë e përshkruan ideja e paaftësisë, e nullitetit politik dhe moral të ballistëve. Përmes imtësirave dhe skenave të goditura satirike, shkrimtari tregon se ballistët, që mundohen ta paraqesin vehten si forcën politike, që historia i ka caktuar të shpejtojnë fatet e Shqipërisë, s'janë veçse llafazanë, që dinë vetëm të mbajnë fjalime bombastike dhe fare të paaftë për veprime konkrete në dobi të Shqipërisë.

Por ballistët s'arritën t'i bindnin njerëzit. Pasi populli u ktheu shpinën, krerët e Ballit i kap tërbimi dhe janë gati të bëjnë çdo gjë, madje jo vetëm t'u japin Shqipërinë të huajve, por edhe ta kthejnë në gjermadhë, veç populli të mos fitojë. Të përqafuar me zogistët, reaksionarët e të gjitha ngjyrave, xhandarët dhe me takëmin e agjentëve të nazizmit, ata thurim plane të reja për të përçarë dhe mposhtur lëvizjen e popullit shqiptar. Një fushatë e çfrenuar shpifjesh të ulta shpërtheu kundra lëvizjes Nacional Çlirimtare. Kori i tradhëtarëve me në krye ballistët, njëzëri mallkon, shan e kërcënon të gjithë ata që janë kundra pushtuesit gjerman. Pjestarët e lëvizjes cilësohen të shitur tek i huaji dhe lufta e partizanëve paraqitet si shkatërronjëse për Shqipërinë. Dhe gjithë kjo përcillet me zhurmë të madhe për ta nxjerrë vehten si "shpëtimtarë" të vendit, si patriotë, që u qan zemra për "Atdheun". Me në fund ata e heqin maskën dhe e tregojnë fytyrën e tyre të neveritëshme si tradhëtarë të atdheut, vegla të xhelatëve nazistë, bashkë me të cilët hidhen kundra lëvizjes Nacional Çlirimtare me zjarr dhe hekur.

Krahas me tërbimin, shkrimtari, paraqiti edhe panikun që kap ballistët në prak të çlirimit të vendit. Nëpërmjet të vizatimeve të goditura satirike del frika dhe nervozizmi, që i ka zënë armiqtë përballë forcës së pathyeshme të partizanëve. Ata tmerrohen nga sukseset e ushtrisë së popullit, sepse shohin se po afron ora e shpagimit për krimet e tyre. Për shkrimtarin përpëlitet e ballistëve të janë hequrit e tërë reaksionit të brendshëm, që e polli këtë organizatë tradhëtare. Me Ballin Kombëtar demaskon me vulën e tradhëtisë bejlerët, tregëtarët e pasur, nepunësit e lartë dhe të gjithë intelektualët antipatriotë.

Tregimi në "Epopenë e Ballit Kombëtar" shtillet në disa plane. Së pari

kemi vizatimin e mprehtë satirik të armiqëve prej vetë shkrimtarit. Ky plan mplekset ngushtë me paraqitjen objektive të ballistëve, të cilët zbulojnë thelbin e vet pseudopatriotik nëpërmjet fjalëve që thonë. Fjalimet e tyre s'janë veçse një vetëdemaskim, që mbështetet në parodizimin e vetvetes. Plani i tretë lidhet me paraqitjen e popullit, i cili jep gjykimin e vet mbi veprat e Ballit Kombëtar.

"Epopeja e Ballit Kombëtar" është ngritur mbi themelet e humorit të popullit të thjeshtë. Veprat, sjelljen dhe planet e ballistëve poeti i stigmatizon, duke përdorur gjërësisht shprehjet humoristike popullore dhe proverba.

Sapo doli në dritë, "Epopeja e Ballit Kombëtar" u bë shpejt e njohur ndër të rinjt antifashistë dhe partizanët. Vepra u shtyp me tipografi në 2500 kopje dhe brenda pak kohe garkulloi në mijra kopje të tjera, të shtypura me çiklostil, me maqinë daktilografike dhe madje me dorë. E thurur si alternim i fjalimeve të krerëve të Ballit Kombëtar me rrefimin e autorit dhe ndërhyrjet e daj Cenit, ajo mësohej përmëndësh dhe dramatizohej e luhej si sheç në mbledhjet e popullit dhe në çetat partizane.

Në këtë kohë vijoi krijimtarinë e tij poetike edhe Aleks Çaçi. Ai shkroi një tok vjershësh, prej të cilave disa u botuan në shtypin e luftës, kurse pjesa tjetër mbeti në dorëshkrim. Në shumë krijime të poetit gjeti shprehje hovi, që mori qëndresa popullore kundra agresorëve fashistë. Në vjershën "Populli tufan" dallojmë gëzimin që ka mbushur poetin, kur sheh si masat, duke hedhur pengesat e ndryshme, janë ngritur në luftë për të fituar pavarësinë dhe siguruar çlirimin e tyre shoqëror. Poeti jep pamjen energjike e plot vrull luftarak të Shqipërisë, që po përleshet me armiqt e vet, vizaton aspekte heroike të luftës, paraqet figurat e luftëtarëve të lirisë. ("Rinia shqiptare", "Po ngrihet lartë Shqipëria", "Përpara në luftë" etj). Në vjershën e parë A. Çaçi i këndon me ton të ngritur dhe gjithë pathos burror aktit të mrekullueshëm të rinisë shqiptare, e cila në ditët e rënda të robërisë fashiste iu përgjegj menjëherë thirrjes së atdheut:

Rinia shqiptare me ballin përpjetë,
lufton e patundur për vdekje e për jetë,
lufton pa kursyer as jetën e shtrenjtë,
për vendin e shkelur, për tokën e shenjtë ¹⁾

Motivi i shumë krijimeve të A. Çaçit është ai i heroizmit, që masat e popullit çfaqën në vitet e kacafytjes së ashpër me pushtuesit e huaj, për durimin dhe qëndrueshmërinë për t'u admiruar që ata çfaqën përballë humbjeve dhe fatkeqësive që sjell lufta. Në vjershën "Syri i nënës" poeti vizatoi figurën romantike të nënës shqiptare, që sakrifikoi dashurinë e vet për çlirimin e popullit. Kur djali i vetëm që kish, ra për liri, ajo e fshehu thellë në gji dhëmbjen e saj dhe trokiti derë më derë, duke grishur njerëzit në luftë kundra të huajit:

.....
një sy që e pata nuk e kam,
ai m'u shua si një re,
e pashë e shkoi si rufe,
tani kam bij'e bija shumë,
një popull ngjeshur me liri.

1) A. Çaçi, "Rinia shqiptare", "Kushtrimi i lirisë", 1942, gusht Nr. 1, f. 12.

Si e tregon edhe titulli; poezia "Kujtimit të martirit komunist Ali Demi", i kushtohet njerit prej militantëve të shquar të Partisë Komuniste, që u vranë përpjekje me armiqt në afërsitë e Vlorës. Poeti shpreh idenë, se flijimi i dëshmorëve nuk vajtj kot. Udhën, që ata treguan, e ndoqi populli dhe luftëtarët e tij besnikë:

Dëgjohet fjala jote an'e mb'anë,
Po, ti, pusho i qetë nënë dhe,
pse sot përmbysen frone dhe tiranë,
përmbushet amaneti që na le. ¹⁾

Në periudhën e dytë të zhvillimit të letërsisë revolucionare Dh. S. Shuteriqi shkroi poemën liriko-patetike "O, Ptoleme", "Një poeti neutral", etj. Poema "O, Ptoleme" (1944) e Dh. S. Shuteriqit është një klithmë e thekshme për humbjen e shokut të afërm, me të cilin autorin e lidhnin jo vetëm të njëjtat qëllime në jetë, por edhe kujtimet e viteve të fëmënisë e më vonë shoqëria e ngushtë. Pathosi i veprës qëndron në mbrojtjen e idealeve fisnike të luftës Nacional Çlirimtare, në ngritjen lart të aktit heroik të dëshmorëve, që ranë në fushën e luftës. Përmes thirrjesh patetike, pyetjesh retorike dhe apostrofash të fuqishme rravizohet figura e një të riu me synime të bukura në jetë. Poema është ngritur si një antitezë e gjërë, e shtjelltë, në mes të pjesëmarrësve të lëvizjes Nacional Çlirimtare, që i karakterizon shpirti i pastër dhe morali i lartë, dhe ballistëve, zogistëve e të gjithë pseudopatriotëve, të zhytur në llumin e tradhëtisë e të imoralitetit shoqëror e politik. Për këta të fundit poeti flet me ton satirik, demaskonjës. Kur tregon për shokët e luftës, që u vranë në kohën më të bukur të jetës, autori shfren me mllef kundra intelektualëve pseudopatriotë, që në çastet, kur atdheu kërkonte nga çdo shqiptar i ndershëm të plotësonte detyrën e vet, si bir i këtij populli bën kauzë me armiqt më të egër të Shqipërisë, me fashistët italianë dhe forcat naziste. Me bekimin dhe nën mbrojtjen e tyre bandat kriminele varnin dhe pushkatonin djemtë më të mirë të vendit, të rinjtë, që lanë fletoret dhe bangot e shkollës dhe morën malin për t'i kthyer atdheut nderin dhe lirinë.

Dëshpërimi i madh i poetit, që s'ka të qetësuar, për shokun e humbur, është çfaqur me anë aludimesh të paqarta, asociacionesh të largëta dhe të pakuptueshme, figurash të errëta, që e vështirësojnë shumë kuptimin e idesë poetike.

Ndër shkrimtarët e rinj, që nisën krijimtarinë e tyre poetike në periudhën e robërisë fashiste, gjejmë edhe emrin e Llazar Siliqit. Në vjershat e tija të para poeti i këndon me entuziazëm lëvizjes çlirimtare, hovit patriotik që ka përfshirë të gjithë vendin. Megjithë vuajtjet dhe të zezat që heq nga sunduesit e huaj, Shqipëria nuk iu shtrua zgjedhës fashiste. Kjo e mbush poetin me një hare të papërmbajtur, që shfren me nota të ngritura, plot vrull:

Por s'flen ajo! Në kamb' sot pop'lli mbarë
me zjarr të zemrës djeg edhe qëllon
zaptuesin aq mizor, t'shitun, tradhëtarë, —
robnin kurr s'ka durue, as nuk duron ²⁾

Krenaria për qëndresën e papërkulur të masave popullore ka gjetur shprehje edhe në vjershën "Pezës", të shkruar po me një stil të lartë, dekla-

1) A. Çaçi, "Kujtimit të martirit komunist Ali Demi", "Trumbeta Çlirimtare", 1944, Nr. 4, f. 2

2) Ll. Siliqi, "Rruga e lumtunis", Tiranë, 1950; f. 20

mativ. Përleshja burrërore e tre komunistëve kundër qindra armiqëve, të shoqëruar me tanke në Kodrën e Kuqe, ipet në poezinë "Heroit Vojo Kushi" me ngjyra heroike-legjendare. Heronjt e rrethuar cilësohen "fatosa", ata krahasohen me "luanin, që nuk lidhet", kurse shtëpia ku u rrethuan prej fashistëve thirret "kala".

Vjershat "Brankos", Xhavitit" dhe "Gjikës" na çojnë në sferën e vuajtjeve subjektive të poetit, i cili kujton i helmuar shokët e vet të ngushtë që ranë në luftë. Ata ishin njerëz me dhunti shpirtërore dhe mendore të çmuara, me shpirt dhe synime fisnike në jetë. Ata do t'i ipnin shumë këtij vendi dhe këtij populli, por dora gjaksore i ndau nga rrethi ynë në çastin kur forcat e tyre shpirtërore po shpërthenin me hov. Kujtimi i shokëve të rënë e mbush poetin me hidhërim të madh.

E sot

që në çdo skaj të atdheut tonë

buçet kanga e Liris,

për t'cillën aq punove

dhe jetën tande t're për t'ë dhurove,

dëshroj me t'pas' ktu pranë

e ma kurr mos me t'lanë. . .

Por s'ngjatë shumë vegimi, Xhavit-vlla,

me u knaq' me ty nuk mundem si dikur,

Sa mall

e sa trishtim ! —

S'u baka zemra gur.¹⁾

V.

Një fenomen interesant i viteve të luftës Nacional Çlirimtare është poezija masive. Lëvizja kundra pushtuesve fashistë solli një aktivizim të paparë të masave popullore. Në sajë të punës këmbëngulëse e të palodhur të komunistëve dhe nën ndikimin e ngjarjeve të kohës, atyre u hapën sytë. Energjitë e tyre shpërthyen në mënyrë të veçantë në lëmin e veprimtarisë politike-praktike, por, edhe në fushat e tjera të aktivitetit shpirtëror, u çfaq aftësia krijuese dhe talenti i vegjëlisë. Dëshmi e këtij fakti janë këngët e partizanëve, e të rinjve antifashistë, fshatarëve, malësorëve, patriotëve, etj. që u bënë të njohura përmes shtypit të luftës, në fletë të daktilografuara ose mbeten në dorëshkrim. Një pjesë e autorëve të tyre mbeten të panjohur. Mjaft prej këngëve, duke jetuar në popull e duke fituar tipare të tjera, u bënë pjesë e folklorit gojor.

Poezia masive qëndronte në mezhën e letërsisë dhe të poezisë popullore. Ajo luajti një farë roli në jetën politike e shoqërore të viteve të luftës dhe paraqet një anë të procesit të krijimit të kulturës së re; që po zhvillohej në ato kohë.

Motivi kryesor i poezisë masive është ai i luftës për çlirimin e vendit. Në 'to me hidhërim flitet për atdheun, që lëngon nën thundrën e fashizmit italian, shpjegohet detyra që kanë shqiptarët ndaj atdheut, bëhet thirrje për t'u ngritur kundra zaptontjesve të huaj. Për këtë flasin titujt e shumë poezive të autorëve jo letrarë: "Zëri i atdheut", "Nevoj" e mëmëdheut sot", "Çaste kushtrimi" etj. Një vend të madh në poezinë e tyre ze demaskimi i ballistëve; bajraktarëve, i parisë reaksionare dhe i të gjithë armi-

1) Po aty, f. 29

qëve, që pengonin luftën e popullit për çlirim nga sunduesit italianë. Këta elementë thirren "tradhëtarë" njerëz "të shitur tek armiku".

Përfaqësuesit më të shquar të poezisë masive të lëvizjes Nacional Çlirimtare janë Memo Meto (1911-1944) dhe Shefqet Peçi.

Vjershat e M.Metos janë të thjeshta nga forma, të qarta nga ideja dhe publicistike nga fryma.

Një nga motivet kryesore të krijimtarisë së M.Metos është ai i luftës kundra sunduesve fashistë dhe shërbëtorëve të brendshëm. Me ashpërsi dhe shprehje të ngjeshura emocionalisht, poeti denoncon fashistët, të cilët i quan "qentë e Romës", kurse pushtimin e huaj që ata vendosën në Shqipëri, regjim skllavëronjës. Këto mendime kanë gjetur pasqyrim tek kënga "Në po vuajmë po heqim", të shkruar në stilin e elegjive popullore. Pasi numuron të këqijat, që po heqin shtresat e vegjëlisë, poeti përçon idenë, se punëtorët dhe fshatarët, duhet të bashkohen përballë shtypjes dhe shfrytëzimit të rëndë të huaj.

Në shumë vjersha të M.Metos gjejmë të shprehura aspiratat e shtrenjta të vegjëlisë për t'u çliruar jo vetëm prej robërisë së huaj, por edhe prej zgjedhës shoqërore. Kupa e helmit është mbushur plot; durimi i popullit ka vajtur tek s'mban më. Kjo gjendje shpirtërore e masave popullore formon brendinë e këngës "Për liri", në të cilën në formë publicistiko-agjitative janë formuluar kërkesat e tyre gjatë lëvizjes Nacional Çlirimtare. Shqipëria e pasçlirimit duhet të jetë një Shqipëri e re, ku njerëzit të rrojnë të lirë dhe të lumtur. Ajo duhet të jetë një Shqipëri pa shtypje e shfrytëzim, ku të mos ketë as "fashistë", as "padronë" dhe as "trathëtarë". Motivi i luftës për drejtësi shoqërore kumboi me shprehje patetike të forta sidomos në "Kushtrimi", që u shkroi nën ndikimin ideor të hymnit luftarak të proletariatit ndërkombëtar "Internacionales".

Lufta e guximshme e popullit kundra skllavëruesve fashistë gjeti ushtimë në një tok krijimesh të M.Metos të cilat i shquan dashuria për popullin, fryma e gjallë luftarake, ndjenja e solidaritetit, optimizmi dhe besimi në fitoren e afërtë mbi armiqtë. Tek vjersha "Do dal malit" poeti pikturoi figurën romantike të vajzës shqiptare, që urren fashizmin dhe shkon në mal për t'u bashkuar me të rinjtë e tjerë patriotë, që luftojnë të huajin. Në emër të interesit të lartë të popullit, ajo është e vendosur të përballojë të gjitha vështirësitë që ka jeta partizane, të ftohtit e vapën, urinë e pagjumësinë, e të luftojë me guxim prej djali fashistët.

Jam një vajzë shqipëtare,
vajzë mali,
E kam forcën e kam zemrën
si të djalit.¹⁾

Në vjershën "Grupi i çetës partizane" poeti flet për çetat partizane si qendra që tërheqin të rinjtë e të rejtat më të mira të vendit, "ajkën e Shqipërisë".

Ideja, se liria nuk fitohet pa sakrificë, pa flijime, përbën idenë e vjershës. "U hap lajmi ulërima", e cila përshkohet nga nota të forta patetike.

Si shprehës i dëshirave dhe i synimeve të vegjëlisë së shfrytëzuar, M. Meto i bën jehonë luftës çlirimtare të popujve të shtypur kundra armikut të masave punonjëse, fashizmit, përpjekjeve të tyre burrërore për të groposur rendin e vjetër, që përtoi luftën zaptunjëse. Tek vjersha "Jemi trimat e Ballkanit" poeti transmetoi entuziazmin e lëvizjes çlirimtare të popujve të Ballkanit, të cilët të bashkuar i jipnin grushte të forta sunduesve të paftuar.

1) M. Meto, "Këngë për liri", Tiranë 1955, f. 37

E thurur si rrefimi i një gruaje të thjeshtë italiane për vuajtjet dhe të zezat që fashizmi i solli popullit italian, "Vajtimi i italjankës" shprehu dhëmbjen e thellë të poetit për tragjedinë e madhe të Italisë, të cilën krerët fashistë e hodhën në uri dhe mjerim të papërshkruar.

Krijimet e M. Metos janë relativisht mjaft për kohën, e cila ishte shumë pak e përshtatëshme për veprimtari të tillë dhe veçanërisht po të kemi parasysh jetën plot shqetësime dhe të dëndur me aktivitet politik e ushtarak të poetit. Ai shkroi kushtime luftar, këngë me një frymë të theksuar lirike, hymne, vaje në stilin e këngëve popullore. Por në shkrimet e tij të luftës gjejmë edhe vjersha satirike ("Bashkëfjalim me një bej", "Prefekti në haur", "Azis strategu" etj.), në të cilat ku me humor të ashpër, e ku me satirë të fortë, ve në lojë propagandën e armikut dhe vizaton me ngjyra qesharake disa nga krerët ballistë, që dështuan me turp në orvatjet e tyre për të shpartalluar lëvizjen partizane në jug.

Në frymëzimin e M. Metos ushtroi ndikim kënga popullore historike, tek e cila ai mori shumë elemente artistike (gjinitë, gjuhën poetike). Por krahas kësaj në vjershat e M. Metos gjejmë reminiscenca edhe prej poezisë së Çajupit dhe të këngëve revolucionare të luftës Nacional Çlirimtare.

Për nga ndjenjat ashtu edhe për nga disa elemente të shprehjes poetike, pranë krijimtarisë së M. Metos qëndron vepra e Sh. Pecit.

Tek frymëzimi i tij gjejmë dashurinë e flaktë të vegjëlisë për truallin amtar, burrërinë dhe stoicizmin që çquan popullin përballë vështirësive dhe fatkeqësive të jetës, shpirtin liridashës dhe pavarësinë e karakterit; notat elegjiake karakteristike të këngës labe. Peçi është një poet mjaft prodhimtar, ai ka hartuar një mori të madhe vjershash dhe këngësh me tematikë të ndryshme, lirike dhe shoqërore-politike, pjesa më e madhe e të cilave ka mbetur në dorëshkrim.

Tek "U rrita i varfër" rravizohet figura e të riut nga vegjelia, i pakënaqur ndaj shoqërisë së shfrytëzuesve dhe i gatshëm për të luftuar kundra padrejtësisë e dhunës. Ndjenja e lidhjes me vendlindjen, kujtimet e dashura e të shtrenjta të viteve të rinisë, kanë formuar brumin e vjershave lirike "Bukurit'e Labërisë", "Vatani që dua shumë", "O male me lule", "Gryk' e Hosit" etj. Në këtë të fundit admirimi për natyrën e Labërisë gërshetohet ngushtë me krenarinë, se n'ato vende lulëzojnë virtute të çmuara morale: "nderi, bukuria dhe trimëria". Pamja që del para syve është madhështore e kërcënuese:

Gryk'e Hosit shkalla-shkalla
Kur vjen dimër me fortunë,
Gjemon vendi bubullima,
U bubu ç'e dua unë !)

Pushtimi i atdheut nga armiq e hidhëroi së tepërmi poetin, por ai nuk e jep veten. Në këto çaste të vështira në imagjinatën e tij përherë e më shpesh vjen e çfaqet historia e luftimeve heroike të shqiptarëve për jetë të lirë. Figurat e shquara të së kaluarës si Skënderbeu etj., të bëmat trimërore të Çelo Picarit dhe të kreshnikëve të tjerë të krahinës ia shtojnë besimin, se Shqipëria edhe kësaj here, si përpara do ta tregojë se sa e çmon lirinë dhe pavarësinë:

Gjithënjë në luftë të parëtë tanë,
Me armiq të shumtë, që shkelën vatanë,
Për lirinë, nderin, vatrën e zakonë
Jetënë të jepnin nuk u bëhej vonë.

1) Sh. Peçi, "Përmbledhje vjershash" (Arkivi i Institutit të Folklorit)

Ata të gëzuar shkonin nga kjo jetë
 Po prapa na lanë nderin vërtetë;
 Trashëgim trimrinë, shpatën e Skënderit
 Këngët e lavdisë dhe ahun e nderit.

Ky zakon i lashtë prap' u përtërit:
 Kanë dalë malit burra e të rit,
 Fashizmin luftojnë që pllakosi sot,
 Me Partinë tonë do t'i dalëm zot¹⁾

Në një sërë krijimesh, si "U hap lajmi an'e mbanë", "Këngë labërisht", "Thirrje popullore", "Këngë popullore", "O Shqipëtar", autori shpreh gëzimin për formimin e Partisë, e cila, duke vijuar rrugën e traditave luftarake të lavdishme të vëndit, po ngrumbullon dhe organizon të gjithë shqiptarët e ndershëm, burra e gra, për luftë kundra fashistave italianë. Përkrimi i betejave dhe episodeve të ndryshme nga përpjekjet e partizanëve me armiq, ka formuar brendinë e shumë krijimeve të Peçit ("Dimerit 1944", Bataljonit "Asim Zenelit", "Viti 1944", "Lufta e Cepos", "Mesaplikë luginë e fortë", "Lufta me gjermanë" etj.). Atmosfera luftarake e kohës, emocionet burrërore dhe optimizmi i poetit kanë gjetur në këto vjersha shprehje të drejtpërdrejta, e ndojëherë publicistike, por me bindje të brendëshme e plot sinqeritet.

Krijimtaria e Sh. Peçit përbën një kapitull me vlerë të poezisë masive që njohu një hov të ri gjatë lëvizjes Nacional Çlirimtare.

Letërsia e luftës Nacional Çlirimtare, hyn në fondin e kulturës sonë kombëtare. Ajo është dëshmia artistike e qëndresës burrërore, që populli shqiptar u bëri agresorëve të huaj gjatë luftës së dytë botërore. Me idetë e larta, me të cilat ishte e brumosur, me frymën luftarake që e shquan, e urrejtjen e pashuar kundra sundimit të huaj, nga e cila përshkohet, veprat artistike të kësaj letërsie edhe sot kontribuojnë në edukimin patriotik revolucionar të brezit të sotëm.

Traditat e letërsisë së viteve të luftës çlirimtare po çohen më tej nga shkrimtarët e sotëm shqiptarë, të cilët vijojnë të frymëzohen nga epepeja e lavdishme e luftës Nacional Çlirimtare. Ata i kanë kushtuar dhe po i kushtojnë kësaj ngjarje të madhe krijimet e tyre më të mira.

R é s u m é

A PROPOS DE LA LITTÉRATURE DE LA RESISTANCE ALBANAISE

(1939—1944)

Pendant la deuxième guerre mondiale, en Albanie s'est développé un mouvement de libération nationale puissant contre les envahisseurs fascistes italo-allemands. Cette lutte, conduite par les communistes albanais, a représenté l'effort le plus glorieux que le peuple albanais ait fourni pendant toute son existence: elle lui a permis de conquérir la liberté véritable et l'indépendance nationale complète, de chasser définitivement les envahisseurs étrangers de son pays

1) Po aty

et de s'affranchir une fois pour toutes de l'exploitation rapace des pays impérialistes. La lutte de libération nationale du peuple albanais contre les agresseurs italiens et allemands a une grande importance, du fait qu'avec celle-ci triomphe aussi la révolution populaire qui a anéanti l'ancien régime politique et social et a ouvert la voie au développement de l'Albanie socialiste.

Le mouvement contre l'état de sujétion fasciste a donné naissance et consistance et à une littérature qualitativement nouvelle au point de vue aussi bien des idées que de l'art. Cette littérature a vu le jour comme un reflet de la lutte héroïque des masses populaires à recouvrer la liberté et s'affranchir socialement. Dans les chants, les poèmes, la publicistique et les esquisses ont trouvé leur expression l'enthousiasme révolutionnaire patriotique, qui avait embrassé toutes les forces solides de la nation, les hérosismes et les sacrifices des masses populaires, en conflit avec les envahisseurs étrangers. Poussée dans le feu du mouvement antifasciste de libération du pays, la nouvelle littérature albanaise a concouru à son tour à rendre plus solide la résistance populaire contre les ennemis, en mettant l'accent sur les sentiments patriotiques, en consolidant chez les masses populaires la confiance dans leur propre force et la victoire sur les ennemis, en stigmatisant les manoeuvres de propagande du fascisme et de ses instruments.

En faisant débarquer, le 7 avril 1939, ses forces armées sur la côte est de l'Adriatique, le fascisme italien misait à faire du pays une simple colonie et l'employer comme un pont de passage pour subjuguier les autres peuples des Balkans. Le peuple albanais ne se soumit pas au joug étranger. La résistance qu'il fit le 7 avril 1939 aux agresseurs fascistes et plus tard aussi, alla en grandissant et en s'élargissant toujours davantage.

Un événement remarquable dans l'histoire de la résistance du peuple albanais a représenté l'entrée de l'Union soviétique en guerre contre l'Allemagne nazie et notamment la constitution du Parti communiste albanais le 8 novembre 1941. C'est ainsi que prend son essor une nouvelle phase de la lutte de libération nationale sous la direction des communistes, qu'elle assume un caractère plus organisé et des proportions plus vastes. Outre la consolidation de la résistance populaire dans les villes, en Albanie commence en 1942 la lutte partisane. Dans plusieurs régions du pays opéraient activement des détachements armés, qui harcelaient les forces ennemies, incendiaient des entrepôts, détruisaient les postes des carabiniers et de la milice, etc. Grâce aux efforts des communistes, on obtient ainsi l'union, la participation et l'organisation de tout le peuple albanais en guerre contre les envahisseurs fascistes. Sous l'influence des victoires de l'armée soviétique à l'Est, notamment de la victoire de Stalingrad, le mouvement partisan passe en 1943 à une phase d'essor formidable. En été 1943 est créée l'Armée de libération nationale, qui comptait dans ses rangs 10 000 effectifs, outre les quelques milliers de combattants volontaires dans les campagnes et les unités de guérilla des villes.

Le mouvement du peuple albanais pour la libération se développa dans un âpre conflit avec la réaction intérieure. Celle-ci, craignant l'essor populaire, avait mis sur pied en 1942 son organisation, le "Balli Kombëtar". Celui-ci mit tout son effort à briser l'organisation et la compacité populaire en lutte contre l'étranger. Pour atteindre ces buts, les adhérents au "Balli Kombëtar" n'hésitèrent pas à collaborer ouvertement avec l'armée italienne contre les forces partisans.

Malgré les plans et les velléités ennemies, la vague du mouvement populaire antifasciste devint encore plus menaçante. Elle ne put être enrayée ou soumise ni par les opérations parfaitement organisées, ni par la terreur, les vexations des troupes nazies, qui se substituèrent à celles italiennes en 1943. Les plans des hitlériens et de la réaction intérieure à faire place nette des partisans subs-

sent ainsi un échec honteux. Dans les batailles sanglantes contre les ennemis, l'Armée de libération nationale sort encore plus solide. Au lieu d'enregistrer un affaiblissement de ses rangs, elle augmente sans cesse ses effectifs. Après avoir détruit les plans du commandement allemand, elle passe à l'offensive pour la libération de l'Albanie, ce qu'elle réalise de ses propres forces le 29 novembre 1944.

Les écrivains progressistes albanais ont pris le parti du peuple, du mouvement de libération nationale contre l'envahisseur fasciste. A mesure que la lutte populaire prenait en extension et en profondeur, les littérateurs progressistes augmentaient leur activité, et, par leurs oeuvres, concoururent sensiblement à soutenir la lutte pour la libération. Leur production dans les premières années de la conquête étrangère fut connue par un cercle limité d'hommes, du fait qu'elle resta en manuscrit. Plus tard, l'organisation et la diffusion de la presse clandestine antifasciste, permit à la littérature révolutionnaire de gagner un grand nombre de lecteurs parmi les adhérents du mouvement clandestin.

En suivant le sillon des événements principaux de la vie populaire, la littérature progressiste albanaise a franchi au cours de son chemin deux étapes principales :

I) La première étape prend naissance au lendemain de la conquête fasciste du 7 avril 1939 et arrive jusqu'au 8 novembre 1941, alors que fut fondé le Parti communiste albanaise;

II) La deuxième étape va depuis la fondation du parti, notamment de la presse clandestine, et jusqu'à la libération complète de l'Albanie, le 29 novembre 1944.

De la première étape on a des poèmes et des vers de P. Marko, A. Çaçi, Dh. S. Shuteriqi, et autres, qui expriment la douleur pour la Patrie assujettie au fascisme italien et en même temps la confiance que, comme toujours dans le passé, les Albanais se lèveront à chasser la botte étrangère. Le poème Le 7 avril — l'appel de libération (1939) de P. Marko reflète les sentiments et les inquiétudes qui travaillent la jeunesse progressiste et tous les patriotes à apprendre la triste nouvelle que la Patrie a été envahie par l'étranger. A travers des excursions dans l'histoire passée de l'Albanie, le dessin plein d'enthousiasme et rattachement passionnel à la nature du terroir, les figures héroïques et viriles des Albanais, Marko exprime en même temps l'espoir que ce peuple ne tardera pas à manifester son esprit indomptable, son esprit de liberté. Le poème est un puissant appel pour la guerre contre les fascistes. Le sujet central du poème Horizons de coffre-fort (1940) du même auteur est l'écroulement du capitalisme et le triomphe de la révolution mondiale. En parlant des instants pleins de trouble et d'inquiétude que passait le monde, et notamment l'Europe, Marko déclare qu'après le grand carnage qui ensanglantait le monde à la deuxième guerre mondiale, l'esclavage capitaliste et les régimes fascistes seraient anéantis, les masses laborieuses respireraient librement, elles auraient la possibilité à édifier leur existence sur les bases de la justice sociale, de la liberté et de l'égalité. Horizons de coffre-fort doit être rattachée aux traditions de Maïakovski.

L'inquiétude, la douleur pour l'Albanie asservie en même temps que l'espoir que bientôt les Albanais répondront à l'appel de la Patrie à courir aux armes, forment le contenu des vers d'A. Çaçi (Quousque tandem, Les vagues de la mer, A la liberté, Debout les opprimés, etc.), de Dh. Shuteriqi (À l'Albanie, O soeur, qui nous a dit!), etc.

Une importance de première main pour le développement des nouvelles lettres albanaises a eu la naissance et le développement de la presse clandestine, qui a servi de berceau à la publicistique révolutionnaire, aux chants partisans, à la poésie antifasciste.

A la fondation du Parti communiste, la littérature albanaise révolutionnaire connaît un essor remarquable. Le genre qui se fait distinguer aussi bien pour l'animation que pour la diffusion, a été la publicistique révolutionnaire, qui a mené une activité importante et de grande valeur pour rendre évidents les buts de la lutte et éduquer politiquement les gens. La publicistique antifasciste se rattache intimement à la fondation et à l'organisation de la presse illégale du parti et du Front de Libération nationale. En 1942-1943 paraissent le *Zëri i Popullit* (La voix du peuple), organe du Parti communiste, le *Bashkimi* (L'unité), organe du Conseil général de libération nationale, *Kushtrimi i lirisë* (L'appel de la liberté), organe de l'Union de la jeunesse antifasciste albanaise et d'autres journaux et périodiques dans plusieurs régions du pays et les organes des brigades et des divisions partisans.

Dans le domaine de la publicistique se font distinguer les dirigeants du parti et de la lutte, E. Hoxha, N. Spiru, et les écrivains Sh. Musaraj, A. Çaçi et autres. Dans les articles d'E. Hoxha, parus sur le "*Zëri i Popullit*" et "*Bashkimi*" sont stigmatisés les plans assujettissants des fascistes et l'on rejette les insinuations de la propagande ennemie que l'Italie apportait soi-disant le salut au peuple albanais. On y exprime la confiance que les Albanais ne seront pas induits en erreur par les "fadaïses" des laquais de *Jacomoni & Co*!. L'auteur explique la grande importance qu'a la lutte de libération contre les agresseurs fascistes pour les destinées futures de l'Albanie comme un Etat libre et indépendant. Il exprime la confiance que ce peuple ne permettra pas que les fruits de ses efforts soient cueillis par les classes réactionnaires. Les écrits publicistiques d'E. Hoxha se font distinguer par une exposition animée et émue de l'idée, le caractère énergique, le ton polémique harcelant, l'usage abondant des locutions populaires, l'esprit pathétique. Un autre publiciste éminent du mouvement de libération nationale a été N. Spiro. Il a fait preuve d'être un maître du pamphlet politique. L'objet de sa satire étaient les policiers de clocher, les amis de la Lieutenance fasciste, les agents de la Ve colonne et ses hommes liges qui ne cessaient de débiter des bobards à discréditer la lutte du peuple et de la jeunesse albanaise, les "traîtres", les "hommes à deux faces", "les intrigants professionnels qui ont eu part à toutes les combinaisons politiques", les "intellectuels moisis", les "réactionnaires fanatiques", les "arrivistes dans le domaine de la politique et les écrivailleurs vendus", qui faisaient circuler les feuilles antipopulaires du Balli Kombëtar, *Legaliteti* et de la Kommandatur allemande. L'ironie, le sarcasme, le paradoxe, la confrontation ouverte des faits, la découverte des non-concordances entre l'essence et l'apparence chez les ennemis, les métaphores et les comparaisons réussies, l'expression concise et la phrase brève, voilà les traits qui constituent le style de N. Spiru comme publiciste.

Dans les années de la lutte, une vaste activité publicistique a déployé aussi Sh. Musaraj. Dans le "*Kushtrimi i Lirisë*", le "*Zëri i Popullit*" et le Bulletin de ce dernier, il fit paraître un grand nombre d'articles, de feuilletons politiques, de pamphlets, de tracts, de manifestes, de reportages, d'esquisses littéraires, qui constituent un fonds important des lettres de la lutte de libération nationale. Ces écrits ont donné une contribution appréciable pour la préparation politique des masses populaires. Du nombre des productions publicistiques de Sh. Musaraj on peut mentionner le pamphlet politique Hier et aujourd'hui (1944), son livre à scènes et descriptions Par monts et par vaux avec les partisans de la Ire Division de Choc (1944) et un grand nombre d'esquisses littéraires où il ébauche les figures des gens du commun et des combattants de la liberté.

Pendant les années du mouvement contre les envahisseurs étrangers, une grande diffusion ont connu les chansons révolutionnaires antifascistes. Dans ce domaine sont connus F. Gjata, qui a écrit toute une série de chansons empreintes

de la romantique de la lutte de libération (L'appel, Le Chant de la jeunesse Vengeance, Le vieux et le jeune, Ah, ces montagnes escarpées), K. Jakova, l'auteur de chansons connues Les trois de Shkodër, L'Aigle partisan.

La poésie patriotique révolutionnaire de 1941-1944 a été représentée par la production poétique de Sh. Musaraj, A. Çaçi, Dh. S. Shuteriqi, Ll. Siliqi, et d'autres.

L'épopée du Balli Kombëtar (1944) de Sh. Musaraj est une satire poétique fine, ou l'auteur fait tourner au ridicule l'organisation de la félonie, le Balli Kombëtar, une parodie réussie de la différence entre les actions et les paroles, notamment du ton plein d'emphase et de démagogie des discours patriotiques de ses leaders, qui voulaient passer pour des hommes auxquels soi-disant l'histoire avait confié la haute mission du salut de l'Albanie. La caricature et la charge sont les éléments qui permettent à Musaraj de faire ressortir la nullité politique et morale de ces gens. L'auteur, avec une ironie fine et instantanée, fait le récit des faits des ballistes depuis la capitulation de l'Italie et l'arrivée des nazis jusqu'à la veille de la libération, il s'en prend aux tentatives ridicules qu'ils font pour entraver les masses populaires à prendre dans leurs mains les rênes du pouvoir.

L'épopée du Balli Kombëtar se fait remarquer par l'usage réussi des moyens satiriques du reflet de la vie, l'agilité de fantaisie, l'appui sur un langage figuratif et plein d'animation dans le style de la langue tenue.

Au cours de ces années, A. Çaçi a écrit un grand nombre de vers qui brosaient par des nuances simples, mais pleines de chaleur, l'héroïsme populaire en lutte pour son affranchissement, son esprit solide et indomptable devant les difficultés et les pertes inévitables que porte la guerre (Peuple-ouragan, Le fleuve populaire, Là-haut sur la montagne, L'oeil de mère, Au souvenir du martyr, Le communiste Ali Demi, etc.). Ces créations attestent que dans ces années, A. Çaçi passe d'un reflet estompé de la vie à une représentation des hommes et des choses avec des notes évidentes et effectives.

Dh. S. Shuteriqi a composé dans ces années le poème lyrico-pathétique O Ptolémée (1944), qui est un cri de douleur pour la perte d'un camarade très proche, auquel l'auteur était rattaché non seulement par les mêmes buts de la vie, mais aussi par les souvenirs d'enfance et, plus tard, par une amitié étroite. Le pathos de l'oeuvre réside dans la défense des idéaux nobles de la lutte de libération nationale, dans la présentation à la hauteur de l'acte héroïque des tombés qui ont donné leur vie sur l'autel de la patrie.

Du nombre des jeunes écrivains qui déburent dans le feu de la guerre on trouve aussi le nom de Llazar Siliqi. Dans ses vers de ces années, le jeune Siliqi chante avec enthousiasme au mouvement de libération, il exprime le sentiment de liesse pour l'essor patriotique qui anime tout le pays, il parle avec douleur des camarades qui sont fait le sacrifice de leurs existence sur l'autel de la Patrie (L'Albanie ne sera plus assoupie, A Peze, Au Héros Vojo Kushi, A Djavit, A Branko, A Gjike, etc.).